

A. kohent



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE E MBROJTJES SOCIALE
MINISTRI

Nr. 5445 Prot

Tiranë, më 15.11. 2019

UDHËZIM

Nr. 744, datë 15.11.2019

“PËR MIRATIMIN E STANDARDEVE MINIMALE TË SHËRBIMEVE TË PËRKUJDESIT SHOQËROR PËR VIKTIMAT/ TË MBIJETUARAT/IT E DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE, NË QENDRAT REZIDENCIALE EMERGJENTE (AFATSHKURTËRA) PUBLIKE DHE JOPUBLIKE (STREHËZAT EMERGJENTE)”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe pikës 3 të nenit 27 dhe 51 të ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Miratimin e standardeve minimale të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për viktimat/të mbijetuarat/it e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, në qendrat rezidenciale emergjente (afatshkurtëra) publike dhe jopublike, (strehëzat emergjente), sipas dokumentit që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.
2. Inspektorati përgjegjës për shërbimet e kujdesit shoqëror siguron inspektimin e zbatimit të standardeve, nga subjektet publike dhe jopublike të licencuara.
3. Shërbimi Social Shtetëror siguron monitorimin e zbatimit të standardeve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, prej strukturës së posaçme për shërbimet e kujdesit shoqëror, apo dhe/ose personave juridikë publikë/privatë, që ofrojnë shërbime të kujdesit shoqëror, të cilat financohen pjesërisht apo tërësisht nga buxheti i shtetit.
4. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror dhe inspektorati përgjegjës për shërbimet e kujdesit shoqëror, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.



**STANDARDET MINIMALE
TË
SHËRBIMEVE TË PËRKUJDESIT SHOQËROR**

**PËR VIKTIMAT / TË MBIJETUARAT/IT
E DHUNËS ME BAZË GJINORE
DHE DHUNËS NË FAMILJE
NË**

**QENDRAT REZIDENCIALE EMERGJENTE
(AFATSHKURTËRA)
PUBLIKE DHE JOPUBLIKE
(STREHËZAT EMERGJENTE).**

2019

Hyrje.

Dokumenti i standardeve minimale për ofrimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror me **fokus kryesor strehimin e menjëhershëm dhe afatshkurtër në rastet emergjente**, në qendrat rezidenciale emergjente publike dhe jopublike (këtej e tutje strehëzat emergjente) për gratë dhe vajzat viktima/të mbijetuarat të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, si dhe për anëtarët e tjerë viktima/të mbijetuarat të dhunës në familje, u përgatit me qëllim funksionimin me sa më eficencë të këtyre strehëzave emergjente.

Ky dokument, që mbështetet në një kuadër të gjerë ligjor, u përgatit përmes një procesi konsultimi me pjesëmarrjen e specialisteve të Sektorit të Politikave dhe Strategjive për Përfshirjen Sociale dhe Barazinë Gjinore në Drejtoren e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrotjtës Sociale, specialist/eve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror në nivel qendror e vendor, përfaqësues/eve të organizatave jo fitimprurëse që ofrojnë shërbime strehimi dhe shërbime të tjera mbështetëse për viktimat/të mbijetuarat/it e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, anëtar/eve të Mekanizmave të Referimit në Bashkitë Korçë, Kolonjë, Përmet, Pogradec, Roskovec, Sarandë, përfaqësues/eve të organizatave ndërkombëtare¹, si dhe me mbështetjen e ofruar nga PNUD, përmes vënieve në dispozicion të dy eksperteve² si dhe mbështetjen teknike e logistike përgjatë gjithë procesit të hartimit, deri në finalizimin e dokumentit.

Standardet minimale për strehëzat emergjente janë një parakusht për ofrimin e shërbimit, procesin e licensimit, kontrollit dhe vlerësimit të këtij shërbimi strehimi të menjëhershëm për rastet emergjente dhe për një periudhë të shkurtër kohore, që mund të ofrohet nga subjekte publike dhe jopublike. Në to theksohen kushtet minimale bazë për t'u përmbushur me qëllim ofrimin e shërbimit të strehimit të menjëhershëm dhe afatshkurtër në rastet emergjente dhe për këtë arsy duhet të aplikohen detyrimisht nga të gjitha subjektet publike e jopublike që ofrojnë një shërbim të tillë.

Standardet minimale për strehimin emergjent synojnë mbrojtjen e jetës së grave dhe vajzave, si dhe anëtarëve të tjerë viktima/të mbijetuar/a të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, **për një periudhë relativisht të shkurtër kohore, të konsideruar si periudhë emergjente**, deri në sigurimin e një alternative më asfatgjatë të trajtimit dhe zgjidhjes së problemit të strehimit si dhe të dhunës së ushtruar.

Të bazuara në praktikat më të mira në këtë fushë këto standarde reflektojnë parimet ndërkombëtare e kombëtare të barazisë, respektimit dhe garantimit të vlerave dhe personalitetit të individit, të së drejtës për t'u mbrojtur, të mbrojtjes së informacionit për jetën vetjake, të dinjitetit dhe sigurisë, etj. Prandaj dhe vënia në zbatim e tyre, garanton ofrimin e një shërbimi cilësor të strehimit emergjent për gratë dhe vajzat, pavarësisht moshës, etnisë, nevojave të veçanta apo aftësive të kufizuara, përkatësisë fetare, identitetit gjinor apo orientimit seksual të tyre, si dhe për individët e tjerë viktima/të mbijetuar/a të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, përfshirë fëmijët e dhunuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë, fëmijë që asistojnë në skena dhune në familje, fëmijë të neglizhuar, abuzuar, etj.

¹ Një listë e plotë e institucioneve kontribuese dhe pjesëmarrës/eve në tryezën konsultuese do të gjendet bashkëlidhur ketij dokumenti si shtojcë 1

² Znj. Monika Kocaqi dhe Zj. Aurela Bozo

TABELA E PËRMBAJTJES

I. INFORMACION I PËRGJITHSHËM.....	3
II. BAZA LIGJORE	5
III. KONCEPTE DHE PËRKUFIZIME	6
IV. PARIMET THELBËSORE PËR TË GJITHA STANDARDET	9
V. STANDARDET MINIMALE, KRITERET DHE TREGUESIT.....	10

I. INFORMACION I PËRGJITHSHËM.

Gratë dhe vajzat, si dhe anëtarët e tjerë të familjes, të cila/ët përballen me incidente të dhunës së ushtruar ndaj/në prani të tyre, kanë nevojë për një sërë shërbimesh dhe për mbështetje të specializuar, me qëllim që t'u sigurohet mbrojtje, trajtim dhe mundësi për zgjidhjen e situatës së tyre, deri në ri-integrim të plotë. Shërbimet mbështetëse janë të shumëllojshme dhe në bazë të Konventës së Stambollit, ndahan në shërbime mbështetëse, *të përgjithshme* dhe *të specializuara*. Strehimi (edhe ai i menjëhershëm dhe afatshkurtër) në një vend të sigurt, i aksesueshëm 24 orë në 7 ditë të javës, është një nga shërbimet mbështetëse të specializuara, sipas Konventës së Stambollit, që sigurisht duhet të ofrohet në bazë të një sërë standardesh. Standardet minimale kërkojnë ofrimin e një shtrati në strehëz për 10.000 banorë³.

Sipas nenit 23 të Konventës së Stambollit:... “*Shtetet palë duhet të marrin masat e nevojshme përfshirë dhe ato legislative, për të mundësuar ngritjen e strehëzave të përshtatshme, lehtësishët të aksesueshme dhe në një numër të mjaftueshëm, për të ofruar akomodim të sigurt dhe për të arritur në mënyrë pro-aktive tek viktimat/të mbijetuarat, veçanërisht për gratë dhe fëmijët e tyre. Strehezat duhet të sigurojnë akomodim të menjëhershëm, të sigurt dhe mundësishët gjatë 24 orëve për viktimat/ të mbijetuarat, në mënyrë të veçantë për gratë dhe fëmijët, kur nuk janë më të sigurt në shtëpitë e tyre. Vetëm strehimet e përkohshme apo strehezat e përgjithshme si p.sh. shtëpitë për të pastrehët, nuk janë të mjaftueshme. Strehezat e specializuara për gratë janë të pajisura në mënyrën më të mirë të mundshme, për të trajtuar problemet e shumëfishhta e të ndërthurura, me të cilat ndeshet njëherazi viktima/e mbijetuara, duke bërë të mundur mbështetjen e grave dhe fëmijëve të tyre, për t'u përballur me eksperiencat traumatike, për t'u larguar nga një marrdhënie e dhunshme, për të rifituar vetëbesimin dhe për të krijuar bazat e një jete të pavavarur të zgjedhur nga vetë ato. Njëkohësisht, strehezat e grave luajnë rol kryesor në krijimin e rrjeteve, mundësojnë bashkëpunimin ndërmjet agjencive dhe rritjen e ndërgjegjësimit në komunitetet respektive...*”

Dy janë sfidat kryesore me të cilat përballemi, gjatë ofrimit të shërbimit të akomodimit të viktimate/të mbijetuar/ave të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje në Shqipëri: (i) rritja e numrit të shërbimeve në mbështetje të grave e vajzave, duke përfshirë edhe strehezat afatgjata dhe strehezat emergjente, si dhe (ii) rritja e cilësisë së shërbimeve në mbështetje të grave, vajzave dhe anëtarëve të tjerë të familjes, viktima/të mbijetuarat të dhunës. Nevoja për shtimin e numrit të shtretërve dhe strehezave në Shqipëri, si dhe për përmirësimin e cilësisë së shërbimit dhe efektivitetit të shërbimeve ekzistuese të strehimit, është identifikuar në një sërë studimesh apo dokumentash të politikave në vend. Kështu, në studimin “*Hartëzimi i shërbimeve për dhunën ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri*”, realizuar në vitin 2015 me mbështetjen e Këshillit të Evropës dhe UN Women, theksohet se: “... duke marrë në konsideratë numrin e kohën e zhvillimit të studimit, numrin e shtretërve që pritet të plotësohen deri në fund të vittit 2015, si edhe numrin e popullsisë, krahasuar me standardet sipas Këshillit të Evropës, Shqipëria duhet të sigurojë edhe të paktën 127 shtretër...”. Ndërkohë që i njëjti shqetësim për plotësimin e numrit të shtretërve të disponueshëm, shprehet edhe në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Planin e saj të Veprimit 2016-2020, miratuar me VKM nr.733, datë 20.10.2016⁴.

Kjo nevojë është identifikuar gjithashtu edhe nga anëtarë të Mekanizmave të Referimit dhe trajtimit të rasteve të dhunës në marrëdhënet familjare në bashki të ndryshme gjatë punës së tyre për trajtimin dhe menaxhimin me sukses të rasteve. Në kuadër të masave për të

³Këshilli i Evropës/ Task Force për të lufuar dhunën ndaj grave, duke përfshirë dhunë në familje (2008): Raporti përfundimtar Stasburg: standardi minimal i cituar në raportin shpjegues të Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftrimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje 2011.

⁴ http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2016/PDF-2016/201-2016.pdf

përmbushur nevojën për strehim, është shumë e rëndësishme të merret në konsideratë gjithashtu kërkesa në rritje nga të gjithë anëtarët e Mekanizmave të Referimit dhe trajtimit të rasteve të dhunës në marrëdhëni familjare (të ngritura aktualisht në 39 bashki të vendit) për të pasur më shumë strehëza emergjente (të cilat sigurojnë strehim të menjëherëshëm dhe afatshkurtër) në dispozicion për adresimin e situatave emergjente të grave dhe vajzave të cilat kanë raportuar dhunën dhe/ose janë në procesin e marrjes së një urdhëri të menjëherëshëm mbrojtjeje. Gjithashtu, shërbimet e strehimit mbeten të pa aksesueshme për disa nga grupet e grave dhe vajzave, sidomos për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, me probleme të shëndetit mendor, me varësi nga substanca të ndryshme, gratë e moshuara, gratë dhe vajzat LBTI, gratë dhe vajzat rome dhe egjiptiane, gratë dhe vajzat e zonave të thella rurale, etj, kjo si për shkak të mungesës së informacionit për ekzistencën e shërbimeve të specializuara, mungesës së mbulimit territorial me shërbime të tillë, pamjaftueshmërisë së shtretërve në dispozicion, mos përshtatshmërisë infrastrukturore apo edhe për shkak të mungessës së stafit të kualifikuar për trajtimin e këtyre grupeve të grave e vajzave në qendrat ekzistuese.

II. BAZA LIGJORE.

Baza ligjore kryesore mbi të cilën është mbështetur hartimi i standardeve minimale për ofrimin e shërbimit të strehimit të menjëhershëm dhe afatshkurtër në strehëzat emergjente, listohet në vijim:

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë⁵.
2. Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit), ratifikuar me Ligjin nr. 104/2012⁶, nen 22 “Shërbimet mbështetëse të specializuara” dhe nen 23 “Strehëzat”.
2. Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, nen 17, ”Strehëzat”.
3. Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar. me ligjin nr.9914, datë 12.5.2008, ligjin nr. 10 329, datë 30.9.2010 dhe ligjin nr.47/2018.
4. Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”;
5. Ligji nr. 35/2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i procedurës penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar
6. Ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”;
7. Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”
8. Ligji nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;
9. Ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social”
10. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.505, datë 13.07.2011 për “Standartet e Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror për Viktimat e Dhunës në Familje”, në qendrat rezidenciale publike dhe jo publike
11. Udhëzimi nr. 13, datë 17.12.2012, “Për zbatimin e standarteve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për viktimat e dhunës në familje, në qendrat rezidenciale, publike dhe jo publike”.
12. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 334, datë 17.2.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”;
13. Marrëveshjet e bashkëpunimit për formalizimin e Mekanizmit të Referimit dhe trajtimit të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, të nënshkruara në nivel bashkie.
14. Vendimi nr. 425, datë 27.6.2012, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale, publike dhe jopublike, të përkujdesjes shoqërore", i ndryshuar;
15. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 839, datë 3.12.2014, Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 425, datë 27.6.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale, publike dhe jopublike, të përkujdesjes shoqërore”.

⁵ Miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 të Kuvendit Popullor. Miratuar me referendum më 22.11.1998 Shpallur me dekretin nr. 2260, datë 28.11.1998 të Presidentit të Republikës, Rexhep Mejdani Ndryshuar me ligjin nr. 9675, datë 13.1.2007 Ndryshuar me ligjin nr. 9904, datë 21.4.2008 Ndryshuar me ligjin nr. 88/2012, datë 18.09.2012 Ndryshuar me ligjin nr. 137/2015, datë 17.12.2015 Ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, date 22.07.2016.

⁶ Si dhe rregjistruar në faqen e Konventës në datën 04.02.2013 (shiko:
<http://www.conventions.coe.int/Treaty/Commun/ChercheSig.asp?NT=210&CM=&DF=&CL=ENG>

16. Vendim i Këshillit të Ministrave nr.353, datë 12.06.2018, “Për rregullat e funksionimit të grupit teknik, ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijëve, pranë bashkive dhe njësive administrative”.

III. KONCEPTE DHE PËRKUFIZIME

Standardet minimale të shërbimeve për viktimat/të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje në strehëzat emergjente u referohen koncepteve dhunë, dhunë ndaj grave, dhunë në familje, pjesëtarë të familjes, etj., siç përkufizohen në Konventën e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” si dhe ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëni familjare” (i ndryshuar), apo edhe në ligje të tjera.

- a) **“Dhunë”** është çdo veprim ose mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cënim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik⁷.
- b) **“Dhunë ndaj grave”** kuptohet si shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi kundër grave dhe nënkupton të gjitha aktet e dhunës gjinore, që çojnë ose mund të çojnë në dëmtim ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike për gratë, duke përfshirë kërcënime për kryerjen e këtyre akteve, shtrëngim ose heqje arbitrale të lirisë, qoftë nëse ndodh në jetën publike ose private⁸;
- c) **“Dhunë në familje”** nënkupton të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike, që ndodhin brenda familjes ose njësisë shtëpiake, ose ndërmjet ish-bashkëshortëve ose partnerëve, ose ndërmjet bashkëshortëve ose partnerëve aktualë, pavarësisht nga fakti nëse autori i veprës penale ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimen⁹;
- d) **“Gjini”** nënkupton rolet e ndërtuara në kontekstin social, sjelljet, aktivitetet dhe atributet që një shoqëri e caktuar i konsideron të përshtatshme për burrat dhe gratë¹⁰;
- e) **“Dhunë gjinore kundër grave”** nënkupton dhunën që drejtohet kundër një gruaje për faktin se ajo është grua ose që prek gratë në mënyrë disproporcionale¹¹;
- f) **“Viktimë”** nënkupton çdo person fizik që i nënshtronhet sjelljes së përcaktuar në pikat “a” dhe “b”¹²;
- g) **“Urdhër mbrojtjeje”** është urdhri i lëshuar me vendim gjykatë, ku parashikohen masat mbrojtëse për viktimen, fëmijët dhe sipas rastit, masa për rehabilitimin e dhunuesit¹³.
- h) **“Urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje”** është urdhri i lëshuar përkohësisht me vendim gjykatë, i vlefshëm deri në lëshimin e urdhrit të mbrojtjes me vendim gjykatë¹⁴.
- i) **“Urdhri për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme”** është urdhri i arsyetur dhe i lëshuar sipas parashikimeve të nenit 13/1, të këtij ligji, që përmban masat e menjëhershme për ndalimin e dhunës, që merren nga organet përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje pranë Policisë së Shtetit, deri në marrjen e vendimit nga gjykata.”.
- j) **“Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të rasteve të dhunës në familje”** (më poshtë MKR) është rrjeti i organizuar i institucioneve përgjegjëse në nivel vendor për

⁷ Ligji nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëni familjare”, i ndryshuar, neni 3, “Përkufizimet”, pika 1.

⁸ Konventa e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, Neni 3 – Përkufizimet.

⁹ Konventa e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”. Neni 3 – Përkufizimet.

¹⁰ Ibidem.

¹¹ Ibidem.

¹² Ibidem.

¹³ Ligji nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëni familjare”, i ndryshuar, neni 3, “Përkufizimet”, pika 10.

¹⁴ Ligji nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëni familjare”, i ndryshuar, neni 3, “Përkufizimet”, pika 11.

- parandalimin, mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje¹⁵.
- k) “*Njësi shtëpiake*” është banesa ose çdo mjedis i përdorur dhe i përshtatur si i tillë, pavarësisht nëse është në pronësi ose në përdorim të familjes¹⁶.
 - l) “*Shërbime rezidenciale*” janë shërbime të kujdesit njëzet e katër orësh dhe afatgjatë për individë në nevojë (fëmijë ose të rritur), të ofruara në qendrat rezidenciale, publike dhe jopublike¹⁷.
 - m) “*Strehëzat emergjente*” ofrojnë akomodim të menjëherëshëm, të sigurtë, afatshkurtër, mbështetës dhe të specializuar për çdo grua viktimë të dhunës, përfshirë dhunën në familje dhe/ose fëmijët e saj. Ato mund të ofrojnë shërbime, vetëm nëse përmbushin standardet e përcaktuara në këtë dokument dhe ky rregull duhet të aplikohet edhe në ambjentet e ngritura deri tanë për ofrimin e shërbimit të strehimit emergjent, në disa bashki në vend, ambjente këto publike (të ngritura apo që menaxhohen nga bashkitë) ose edhe jo-publike (të ngritura ose që menaxhohen nga OJF-të e specializuara). Llojet e shërbimeve që do të ofrohen në këto ambjente dhe në strehëzat emergjente janë “shërbimet në qendrat rezidenciale, përfshirë strehëzat”. Shërbimi në strehëza është shërbim i kujdesit shoqëror rezidencial i ofruar në mënyrë të përkohshme, që përfshin shërbimin e specializuar, strehimin, sigurinë fizike, ushqimin, kujdesin shëndetësor, rehabilitimin psiko-social, terapinë fizike, aktivitete profesionale, kalimin e kohës në komunitet, edukimin, në varësi të nevojave të identifikuara dhe të zgjedhura nga përfituesit. Ky shërbim mund të ofrohet gjatë të gjitha ditëve të javës dhe përfshin edhe referimin në një shërbim tjetër shoqëror¹⁸.
 - n) “*Shërbime të specializuara*” në strehëzën emergjente janë shërbimet e ofruara nga profesionist/e të profilizuar/a në specialitete të ndryshme. Këto shërbime do të ofrohen në nivel qarku/rajonal dhe bashkie për gratë dhe vajzat e abuzuara, të dhunuara, si dhe për fëmijët e tyre të abuzuar, apo për anëtarët e tjerë të familjes që pësojnë dhunë.
 - o) “*Përfitues/i/e shërbimeve të kujdesit shoqëror në strehëzat emergjente*” është individi që sipas vlerësimit nga koordinator/ja vendor/e kundër dhunës në familje dhe/ose punonjës/ja social/e e njësisë së vetëqeverisjes vendore përmbush kushtet e një viktime ose viktimë e mundshme, për të përfituar të drejtat nga shërbimi shoqëror, së bashku me fëmijët e tij/saj. “*Fëmijë përfitues*” është çdo individ deri në moshën 18 vjeç, përfitues i shërbimeve të kujdesit shoqëror, sipas nenit 3, pika 8 të ligjit nr.121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”
 - p) “*Situatë emergjente*” është një situatë kritike, e përkohshme ose jo, e shkaktuar nga faktorë shoqërorë, që sjellin apo mund të sjellin dëme të menjëherëshme, të rënda ose që dëmtojnë seriozisht jetën, shëndetin apo mirëqenien e individit në rast se nuk merren masa urgjente dhe ndaluese¹⁹.
 - q) “*Punonjës/e social/e i njësisë së vetëqeverisjes vendore*” është profesionist/ja, sipas legiislacionit përkatës në fuqi, në njësitë e vlerësimit të nevojave dhe referimit të rasteve, që do të jetë përgjegjës/e për identifikimin e nevojave, referimin, menaxhimin dhe ndjekjen në vazhdim të rasteve²⁰.

¹⁵ Ligji nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marredhëniet familjare”, i ndryshuar, neni 3, “Perkuftizimet”, pika 5.

¹⁶ Ligji nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marredhëniet familjare”, i ndryshuar, neni 3, “Perkuftizimet”, pika 6.

¹⁷ Ligj nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”

¹⁸ Ligj nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, neni 17.

¹⁹ Ligj nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, “Perkuftizime”, pika.14.

²⁰ Ibidem, neni 3, “Perkuftizime”, pika.24.

- r) “*Punonjës/e i shërbimeve sociale*” është i/e punësuar/a në shërbim të kategorive përfituese të shërbimeve të kujdesit shoqëror, si pjesë e sistemit publik dhe jopublik të ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror.²¹
- s) “*Menaxhim i rastit*” është sigurimi dhe bashkërendimi i referimit të individëve në nevojë për kujdes shoqëror në të gjithë procesin e ofrimit të shërbimit, sa herë që të jetë e nevojshme, deri në integrimin e plotë të tyre²².
- t) “*Vend familjar*” - një vend që akomodon një grua me fëmijët e saj bazuar në numrin mesatar të fëmijëve për familje në vendin tonë. Kështu që ky do të jetë më shumë se një shtrat²³.
- u) “*Fëmijë*” është çdo individ deri në moshën 18 vjeç.
- v) “*Standardet minimale*” janë standardet më të ulëta apo standardet bazë që duhet të synohet të plotësohen nga të gjitha shtetet dhe shërbimet. Standardet mundësojnë kufijtë dhe rregullat për shtetet dhe ofruesit e shërbimeve, përsa i takon shtrirjes dhe miksimit të shërbimeve që duhet të janë në dispozicion, kush duhet t'i ofrojë këto shërbime, si dhe parimet dhe praktikat bazë me të cilat ato duhet të veprojnë. Këto standarde minimale janë në një farë mënyre inspiruese, duke pasur parasysh që shumë shtete ende nuk kanë plotësuar numrin e duhur të shërbimeve të specializuara, apo shumë të tjera nuk arrijnë ende të plotësojnë standardet edhe thjesht sipas politikave të vendit, praktikave dhe burimeve në dispozicion. Gjithsesi këto standarde përfaqësojnë nivelin dhe cilësinë e shërbimeve në të cilat duhet të kenë qasje dhe disponibilitet të gjitha gratë nëpër Evropë. Praktikat e mira duhet të përfshijnë standardet minimale por edhe të shkojnë përtëj tyre duke synuar maksimumin e qasjes, cilësisë dhe rezultateve pozitive²⁴.

²¹ Ligj nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, nen 3, “Përkufizime”, pika.28.

²² Ligj nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, nen 3, “Përkufizime”, pika.25.

²³[https://www.coe.int/t/dg2/equality/domesticviolencecampaign/source/eg-va&c-conf\(2007\)study%20rev_en.pdf](https://www.coe.int/t/dg2/equality/domesticviolencecampaign/source/eg-va&c-conf(2007)study%20rev_en.pdf)

²⁴ “Të luftosh dhunën ndaj grave: standardet minimale për shërbimet e specializuara”, Prof. Liz Kelly dhe Lorna Dunois (2008). <http://eee.coe.int/equality/>

IV. PARIMET THELBËSORE PËR TË GJITHA STANDARDDET

Strehëzat emergjente për viktimat/të mbijetuarat e dhunës më bazë gjinore dhe dhunës në familje, duhet t'i ofrojnë shërbimet e tyre të menjëherershme dhe afatshkurtëra, në përputhje me parimet thelbësore të mëposhtme:

1. *Parimi i respektimit të të drejtave të njeriut dhe integritetit të përfitueses/it.* Ofrimi i shërbimit të strehimit emergjent duhet të bazohet në respektimin e të drejtave të njeriut, integritetit të individit, besimit fetar, përkatësisë etnike, identitetit gjinor apo orientimit seksual, respektimit dhe plotësimit të kushteve për trajtimin e paftësive fizike e mendore apo nevojave të veçanta, si dhe formimit të gjithanshëm të saj/tij.
2. *Parimi i mosdiskriminimit.* Ndalohet çdo formë e diskriminimit të përfitueses/it të shërbimeve të strehimit emergjent, bazuar në nenin 1, "Objekti", të ligjit Nr.10 221, datë 4.2.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi".
3. *Parimi i partneritetit.* Funksionimi i sistemit të shërbimeve shoqërore bazohet në një bashkëpunim të ngushtë midis qeverisjes qendrore dhe vendore, si financues kryesorë të shërbimeve shoqërore me organizatat joftimprurëse dhe subjektet e tjera jopublike, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre ofrimin e shërbimeve shoqërore për individët dhe familjet që kanë nevojë për kujdes shoqëror.²⁵
4. *Parimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.* Të dhënat personale të individit që trajtohet me shërbime të strehimit emergjent, janë konfidenciale dhe mbrohen e përpunohen sipas ligjit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Koordinator/ja Vendore kundër dhunës në familje, punonjës/ja social/e e njësisë së vetëqeverisjes vendore, si dhe çdo person tjetër i angazhuar në ofrimin e shërbimit të strehimit emergjent ruan konfidencialitetin e të dhënave personale të individit, për të cilat ka marrë dijeni si pasojë e funksionit apo detyrës që kryen. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit shtrihet edhe pas përfundimit të marrëdhënies së punës, funksionit apo detyrës.
5. *Parimi i subsidiaritetit.* Shërbimet e kujdesit shoqëror ofrohen sa më pranë qytetarëve dhe për sa është e mundur nga strukturat vendore²⁶.
6. *Siguria dhe dinjiteti njerëzor.* Shërbimet që do të ofrohen në strehëzat emergjente duhet të mundësojnë që të gjitha ndërhyrjet të prioritizojnë sigurinë dhe dinjitetin e përdorueseve të shërbimeve dhe stafit.
7. *E drejta e marrjes së vendimit për ta përfituar shërbimin, bazuar në dhënien e një informacioni të plotë e të përditësuar.* Do të jenë gratë, të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje që do të vendosin për jetën e tyre dhe sigurinë e jetës. Eshtë e rëndësishme t'i shpjegohet të mbijetuarës së dhunës se ajo duhet të marrë vendimin për qëndrimin e saj në strehëzën emergjente me qëllim dhënien fund dhunës dhe jo përfundimin e marrëdhënies me dhunuesin, anëtar i familjes. Vendasja e grave dhe fëmijëve përfitues/e në strehëzat emergjente bëhet me pëlqimin e tyre me shkrim (ose të përfaqësuesit ligjor, në rastin e fëmijëve), pasi t'u jetë dhënë i gjithë informacioni i nevojshëm si në lidhje me shërbimet që ofrohen në strehëzën emergjente, ashtu edhe mbi tërësinë e shërbimeve të akomodimit në dispozicion, qofshin këto shërbime emergjente apo afatgjata.

²⁵ Ligj nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", neni 4 "Parimet", pika.dh.

²⁶ Ligj nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", neni 4 "Parimet", pika.c.

V. STANDARDET MINIMALE, KRITERET DHE TREGUESIT

STANDARDI 1:

Shërbimet e ofruara në strehëzën emergjente duhet të janë në përputhje me natyrën e këtij lloj shërbimi, të menjëhershëm e afatshkurtër, duke i dhënë rëndësi të kuptuarit të dhunës ndaj grave dhe vajzave, si shkak dhe pasojë e pabarazive dhe diskriminimit ndërmjet grave dhe burrave.

Rezultati i dëshiruar:

Shërbimet e ofruara demonstrojnë një qasje të përshtatshme dhe të informuar për përdorues/et e shërbimit, që njeh dhe kupton dinamikën dhe ndikimet e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, brenda barazisë dhe kuadrit të të drejtave të njeriut.

STANDARDI 1.1.:

Shërbimi i ofruar në strehëzën emergjente promovon të kuptuarit, se dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje janë të papranueshme dhe shkelje të të drejtave të njeriut.

KRITERET	TREGUESIT	UDHËZIMET
<ul style="list-style-type: none"> - Ofroesi i shërbimit të ketë një dokument me përkufizime të qarta në lidhje me dhunën ndaj grave dhe vajzave, dhunën në familje, etj. - Staf i duhet të punësohet bazuar në qasjen dhe qëndrimin që mban ndaj këtyre formave të dhunës. - Aktivitetet për fuqizimin e kapaciteteve, të theksojnë vazhdimisht qasjen që duhet tē udhëheqë punën në strehëzën emergjente - Shërbimi i ofruar duhet ta reflektojë këtë qasje dhe përdorues/et e shërbimit duhet ta kuptojnë se ajo që u ka ndodhur përbën shkelje të tē drejtave njerëzore 	<p>1.1.1. Ekziston një përkufizim mbi termat "dhunë ndaj grave" dhe "dhunë në familje" që është në përputhje me përkufizimet në legjislacionin kombëtar e ndërkombëtar;</p> <p>1.1.2. Rekrutimi i stafit bëhet duke u bazuar në qasjen njohuritë dhe që ata/o kanë mbi të kuptuarit e këtyre koncepteve.</p> <p>1.1.3. Mënyra e mbajtjes së shënimeve nga stafi (ditari personal për çdo rast të trajtuar, shënimet mbi udhëzimet e dhëna dhe terapinë që duhet tē ndiqet, shënimet mbi ecurinë e rastit dhe përmirësimet e vërejtura, etj) për rastin, si dhe informacioni i dhënë për përdorues/et e shërbimit, tregojnë se stafi e mban dhe promovon qasjen e duhur në këtë drejtim.</p> <p>1.1.4. Nëse lind nevoja, stafi sfidon institucionet e tjera në mënyrë konstruktive, nëse ndeshet me mite apo besime të rreme rreth "dhunës ndaj grave" dhe "dhunës në</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Dokumenti duhet tē përgatitet mbi bazën e përkufizimeve në kuadrin ligjor ekzistues kombëtar e ndërkombëtar. - Duhet punuar vazhdimisht si me stafin ashtu dhe me përdorues/et e shërbimit tē strehimit emergjent, që kjo qasje të gjejë reflektimin e duhur në praktikë.

	<p>familje”.</p> <p>1.1.5. Përdorues/et e shërbimit janë të vetëdijshme se shërbimi i ofruar siguron këtë qasje.</p>
--	--

Shërbimet që do të ofrohen në strehëzat emergjente, duhet të kenë qasje dhe disponueshmëri për të gjitha gratë dhe vajzat dhe/ose fëmijët e tyre të dhunuar, si dhe për të gjithë anëtarët e familjes që kanë pësuar dhunë dhe janë në rrezik të lartë për sigurinë e jetës së tyre; duhet të ofrojnë informacionin e nevojshëm për përfituesit/et e shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe duhet të janë të përshtatshme për të gjith/a përdorues/et e shërbimeve. Njohja e dinamikave gjinore, efekteve dhe pasojave të dhunës ndaj grave në kuadrin e barazisë dhe të drejtave të njeriut, duke përfshirë kuptimin e dhunës ndaj grave si shkak dhe pasojë e pabarazive ndërmjet grave dhe burrave, si dhe nevojën për shërbime vetëm për gratë, përbën një parakusht të rëndësishëm për mirëfunksionimin e këtyre strehëzave emergjente. Të gjitha njësitet e vetëqeverisjes vendore (bashkitë) pranë të cilave ngrihen këto strehëza emergjente duhet të sigurojnë të paktën numrin minimal të stafit të nevojshëm.. *Sigurohet qëndrimi/shoqërimi i të mbijetuarës nga një punonjës/e e specializuar për këtë qëllim, përgjatë gjithë kohës së qëndrimit të të mbijetuarës në strehëzën emergjente, si dhe me tre turne (pra përgjatë gjithë harkut kohor 24 orësh).* Anëtarët e stafit të strehëzave emergjente, ndër të tjera, duhet të kenë përfunduar arsimin përkatës, të janë të pajisura me aftësitë e duhura, të janë të ndjesh/me ndaj këndvështrimit gjinor, t'u mundësohen trajnime të vazhdueshme për këtë lloj shërbimi në mbështetje të viktimate të gjitha formave të dhunës, të njojin dhe respektojnë standardet e funksionimit të strehëzës emergjente për të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, standardet ndërkombëtare, legjislacionin civil, administrativ dhe penal në mbrojtje të viktimate të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, përfshirë aktet nënligjore si VKM nr. 334, datë 17.02.2011, Vendimi nr. 425, datë 27.06.2012, i Këshillit të Ministrave, "Për përcactimin e kritereve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale, publike dhe jopublike, të përkujdesjes shoqërore", i ndryshuar me VKM nr. 839, datë 03.12.2014, Vendim i Këshillit të Ministrave nr.353, datë 12.06.2018, "Për rregullat e funksionimit të grupit teknik, ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijëve, pranë bashkive dhe njësive administrative", etj., si dhe të respektojnë konfidencialitetin e të dhënave të viktimitë/të mbijetuarës së çdo forme dhune, bazuar në ligjin Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, të ofrojë shërbime pa diskriminim duke zbatuar Ligjin Nr.10 221, datë 04.02.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi", të njoë dhe zbatojë Ligjin nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", Ligjin nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti", Ligjin nr. 22/2018 "Për strehimin social" dhe aktet e tyre nënligjore, etj.

STANDARDI 2:

Shërbimet e ofruara në strehëzën emergjente duhet të plotësojnë nevojat individuale të përfitues/eve si viktima/të mbijetuar/a të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, duke respektuar sigurinë dhe dinjitetin njerëzor të tyre.

Rezultati i dëshiruar:

Shërbimet e ofruara sigurojnë që të gjitha ndërhyrjet t'i jasin përparësi sigurisë dhe dinjitetit të përdorues/eve të shërbimit duke marrë në konsideratë nevojat komplekse të tyre si viktima/të mbijetuara të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje.

STANDARDI 2.1.:

Ofruesi i shërbimit të strehimit emergjent ofron një paketë të plotë dhe efektive shërbimesh, në përputhje me nevojat gjinore komplekse të përfitues/eve, viktima/të mbijetuara të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje.

STANDARDI 2.2.:

Ofruesi i shërbimit të strehimit emergjent prioritarizon sigurinë dhe dinjitetin e përdorues/eve të shërbimit, si dhe pranon që përdorues/et e shërbimit, fëmijët e tyre, anëtarët e tjerë të familjes apo dhe stafi që punon me ata/ato, kanë të drejtë të jenë të mbrojtur nga dhuna dhe abuzimi, si dhe duhet të ndërmarrin veprime në përputhje me procedurat për ta mundësuar këtë gjë.

Fëmijët vendosen në përkujdesje alternative ose merren masa mbrojtëse emergjente, për eleminimin e pasojave të dhunimit të fëmijëve prej prindërve ose kujdestarëve ligjorë apo, në rastin kur fëmijët jetojnë në familje ku prindërit ose kujdestarët dhunojnë njëri-tjetrin, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.

KRITERET	TREGUESIT	UDHËZIMET
<ul style="list-style-type: none"> - Ofruesi i shërbimit të strehimit emergjent të ketë një dokument të shkruar me misionin dhe objektivat e shërbimit, të cilat duhet të jenë të shkruara me gjuhë të kuptueshme dhe të afishura në një vend të dukshëm - Shërbimet minimale të ofruara në strehëzën emergjente duhet të jenë: <ul style="list-style-type: none"> ► Strehimi i sigurtë ► Veshja ► Ushqimi ► Mbështetje psikosociale ► Referimi - <i>Shërbime të tjera shtesë që mund të ofrohen, ndër të tjera, janë:</i> <ul style="list-style-type: none"> ► Shërbime psikologjike ► Shërbime mjekësore ► Shërbime ligjore ► Shërbime financiare ► Asistencë edukative/arsimore 	<ul style="list-style-type: none"> 2.1.1. Dokumenti në formë shkresore 2.1.2. Dokumenti i afishuar 2.1.3. Kontrata për shërbimet në dosjen e përfitues/es. 2.1.4. Deklarata e dakordësisë së përfitueses e firmosur brenda 24 orëve. 2.1.5. Formularët e pranimit, raportet e psikologes/punonjëses sociale, deklarata e ruajtjes së konfidentialitetit të të dhënave personale, etj., të plotësuara dhe vendosura në dosjet e përfitues/eve 	<ul style="list-style-type: none"> - Përfitues/ja të ketë nën kontroll fëmijët e saj, nëse ka. - Përfitues/ja të marrë pjesë në administrimin e programit duke u kujdesur për nevojat e saj, pra duke qenë përgjegjëse për hapësirën e saj, fëmijët e saj, gatimin, pastrimin, kujdesin ndaj fëmijës, etj., personalisht ose në grup me përfitues/et e tjer/a. - Kur përfituesja është nënë me fëmijë, fëmija jeton në të njëjtën dhomë me nënën pasi është bërë një vlerësim mjekësor dhe psiko-social i të dyve.
<ul style="list-style-type: none"> - Shërbimi i ofruar reflekton qartë parimet e sigurisë dhe dinjitetit - Shërbimi i ofruar duhet të gjinore dhe dhunës në familje, 	<ul style="list-style-type: none"> 2.2.1. Ofruesi i shërbimit të strehimit emergjent siguron që shërbimet e domosdoshme për trajtimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, 	<ul style="list-style-type: none"> - Stafi duhet të kujdeset dhe marrë masat e nevojshme që çdo përfitues/e të kuptojë të drejtat dhe

bazohet në një plan sigurie për cdo përfitues/e	<p>ofrohen në një vend të sigurt, i vendos përfitues/et në qendër të shërbimit; ofron shërbime në përputhje me nevojat e përfitues/eve; dhe respekton të drejtën e tyre për t'i pyetur nëse duan që shërbimi t'u ofrohet nga personel grua.</p> <p>2.2.2. Procedurat për sigurinë dhe dinjitetin njerëzor janë të shkruara dhe të afishuara për përdorues/et e shërbimit.</p> <p>2.2.3. Stafë është në gjendje të përshkruajë nevojën se përsë shërbimi i ofruar duhet të jetë i ndjeshëm nga këndvështrimi gjinor.</p>	<p>detyrimet e saj, si dhe parimet mbi të cilat mbështetet shërbimi i strehimit emergjent. Nëse përfituesja e shërbimeve kërcënöhët ose vihet në rrezik për jetën gjatë kohës së qëndrimit në strehëzën emergjente, ajo njofton menjëherë stafin e strehëzës emergjente për vlerësimin e rrezikut dhe përditësimin e planit të sigurisë.</p>
---	---	--

Shërbimet që do të ofrohen në strehëzat emergjente duhet të mundësojnë që të gjitha ndërhyrjet të prioritarizojnë sigurinë dhe dinjitetin e përdorues/eve të shërbimeve dhe stafit. Kur nga kryerja e vlerësimit të riskut rezulton se dhuna e ushtruar paraqet rrezik për jetën, shëndetin dhe lirinë e anëtarëve të familjes, strukturat përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, pranë Policisë së Shtetit, marrin menjëherë masa paraprake të mbrojtjes së viktims/ave dhe për ndalimin e dhunës²⁷, ndër të cilat vendosja menjëherë e viktims në një qendër rezidenciale ose emergjencë për viktimat e dhunës në familje deri në marrjen e vendimit nga gjykata²⁸; ndalimi menjëherë i dhunuesit/es, që t'i afrohet strehës²⁹; urdhërimi i një punonjësi të Policisë së Shtetit, që të shoqërojë viktimën në qendrën rezidenciale ose të emergjencës³⁰; urdhërimin e një punonjësi të Policisë së Shtetit që të shoqërojë viktimën deri në vendbanimin e tij/të saj dhe të mbikëqyrë marrjen e sendeve personale³¹, etj.; Në rastet kur dhuna ushtrohet ndaj ose në prani të fëmijëve, Policia e Shtetit merr menjëherë në mbrojtje fëmijën dhe njëkohësisht referon rastin pranë Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve në njësinë e vetëqeverisjes vendore, sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës³². (Gjatë vlerësimit të plotë të rastit të fëmijës në nevojë për mbrojtje, grupi teknik, ndërsektorial, në bashkëpunim me NJMF-në/PMF-në, ka detyrimin të bëjë vlerësimin e nevojës së marrjes së masës së mbrojtjes apo të një urdhri mbrojtje, në kuadër të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëni familjare”, i ndryshuar³³).

Organet përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, pranë Policisë së Shtetit, paraqesin përpresa gjykatës kërkesë për vlerësimin e masave paraprake të mbrojtjes së

²⁷ Ligji Nr. 47/2018, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëni familjare”, të ndryshuar, neni 14, pika 1.

²⁸ Ligji Nr. 47/2018, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëni familjare”, të ndryshuar, neni 14, pika 1, ç;

²⁹ Ligji Nr. 47/2018, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëni familjare”, të ndryshuar, neni 14, pika 1,c;

³⁰ Ligji Nr. 47/2018, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëni familjare”, të ndryshuar, neni 14, pika 1, d;

³¹ Ligji Nr. 47/2018, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëni familjare”, të ndryshuar, neni 14, pika 1, dh

³² Ligji Nr. 47/2018, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëni familjare”, të ndryshuar, neni 14, pika 4.

³³ Vendim i Këshillit të Ministrave nr.353, datë 12.06.2018, “Për rregullat e funksionimit të grupit teknik, ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijëve, pranë bashkive dhe njësive administrative”

menjëhershme dhe kërkesëpadi për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, brenda 48 orëve nga marrja e masave.

Stafi i strehëzës emergjente dhe aktorët në nivel vendor, pjesë e Mekanizmit të Referimit dë trajtimit të rasteve të dhunës në familje dhe GTN për mbrojtjen e fëmijëve duhet të koordinojnë veprimet me qëllim sigurinë e jetës së grave viktima/të mbijetuarës të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje dhe fëmijëve të tyre gjatë kohës së qëndrimit në strehëzën emergjente. Me qëllim sigurinë e të mbijetuarave të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në marrëdhënet familjare dhe vlerësimin e rrezikut, Sektori i shërbimeve sociale pranë bashkive, koordinatorët vendorë kundër dhunës në familje, policia dhe anëtarët e tjerë të Mekanizmave të Referimit, NJMF/PMF të bashkisë dhe/ose njësisë administrative duhet të marrin në konsideratë disa faktorë të rëndësishëm para sistemimit të së mbijetuarës së dhunës dhe/ose fëmijëve të saj në strehëzën emergjente. Disa nga këta faktorë janë: largësia e vendbanimit të së mbijetuarës së dhunës nga strehëza emergjente, historia e incidenteve të dhunës së pësuar nga dhunuesi, niveli i raportimit në të shkuarën dhe të dhëna të policisë ose aktorëve të tjerë në nivel vendor në lidhje me rastin, forma e dhunës së pësuar, kohëzgjatja e saj, e të tjera. Siguria e përfitueseve do të kryhet përmes ruajtjes së adresës së strehëzës emergjente konfidenciale dhe/ose marrjes së masave të duhura të sigurisë dhe monitorimit e mbikqyrjes. Për të garantuar sigurinë e të mbijetuarës së dhunës dhe fëmijëve të saj, ambienti duhet të ruhet me kamera, si dhe subjekti duhet të sigurojë monitorim të pamjeve dhe vendosje të një sistemi alarmi, për të siguruar mbrojtje të menjëhershëm në rast rreziku. Në rastet kur vendndodhja e strehëzës emergjente nuk mund të mbahet sekret, bashkëpunimi me policinë dhe aktorët e tjerë, anëtarë të Mekanizmit të Referimit, merr një rëndësi të veçantë. Kur policia dhe anëtarë të tjerë të Mekanizmit të Referimit në bashkëpunim me të mbijetuarën e dhunës me bazë gjinore apo dhunës në familje, vlerësojnë se dhunuesi paraqet një rrezik të lartë, strehëza emergjente mbikqyret nga një punonjës/e policie, si dhe sigurohet akomodimi në një strehëzë sa më larg vendbanimit të së mbijetuarës së dhunës dhe dhunuesit, pas ditëve të qëndrimit në strehëzën emergjente.³⁴ Viktima e dhunës në familje mund të akomodohet në Qendrën Kombëtare të Përkujdesit Shoqëror për viktimat e dhunës në familje ose në strehëza të tjera të menaxhuara nga organizata të shoqërisë civile.

Për këtë vendim transferimi duhet të merret edhe mendimi i të mbijetuarës së dhunës. Me qëllim sigurinë e viktimës/të mbijetuarës së dhunës në familje, i ofrohet transporti falas dhe i sigurtë për në strehëzë ose në institucionë të tjera, nga Sektori i Shërbimeve Sociale në bashki, koordinatorja vendore kundër dhunës në familje në bashkëpunim me policinë dhe anëtarët e tjerë të Mekanizmit të Referimit.

Vendimi i gjykatës për nxjerrjen e urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes ekzekutohet menjëherë nga organet e polisë, në bashkëpunim me shërbimin përmbarimor gjyqësor dhe zyrën e shërbimeve sociale të njësisë së vetëqeverisjes vendore ku janë me banim të përhershëm ose të përkohshëm viktima dhe personat e tjerë, të parashikuar në vendim. Në këtë kuadër, bashkëpunimi i stafit të strehëzës emergjente me aktorët vendorë është shumë i rëndësishëm.

Shërbimet këshilluese, psikologjike dhe mbështetëse:

Strehëzat emergjente do të ofrojnë siguri, akomodim, këshillim dhe mbështetje për gratë, të mbijetuara të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje si edhe për fëmijët e tyre. Do të përfitojnë nga këto shërbime gratë të mbijetuara të formës së dhunës fizike, seksuale, ekonomike, morale dhe emocionale të ushtruar nga partneri, bashkëshorti dhe/ose pjesëtarë të tjerë të familjes mbështetur në nenin 3, "Përkufizime", p.3 "Pjesëtarë të familjes" dhe nenin 10 "Masat mbrojtëse ndaj dhunës në familje" të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa

³⁴http://fileserver.wave-network.org/trainingmanuals/Aeasy_from_Violence_2004_English.pdf

ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar. Këto shërbime do të ofrohen me fonde të bashkisë, të pushtetit qendor ose/dhe në bashkëpunim me organizatat jo fitimprurëse që punojnë në këtë fushë në nivel bashkie ose qarku.

Shërbimet e ofruara nga stafi i strehëzës emergjente përfshijnë:

- ✓ Hartimin dhe zbatimin e një plani sigurie për çdo përfitues/e, në bashkëpunim me policinë, koordinatoren vendore kundër dhunës në familje dhe anëtarët e tjerë të Mekanizmit të Referimit;
Pjesë e këtij plani është edhe Urdhri për masat paraprake të mbrojtjes së menjëherëshme. Ky plan sigurie do të përfshijë masa jo vetëm për ditët e qëndrimit të viktimës/ave në strehëzën emergjente, por edhe gjatë transferimit të viktimës për në strehëza të tjera si dhe kthimin e saj në familje.
- ✓ Këshillime psikologjike për gratë dhe fëmijët, të mbijetuar/a të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në marrëdhëniet familjare;
- ✓ Ndihmë juridike parësore dhe referim për ndihmë juridike dytësore mbi përdorimin e mjeteve ligjore të parashikuara në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, legjislacionin penal, etj.;
- ✓ Këshillime mbi mbështetjen financiare që përfitojnë të mbijetuar/at e dhunës në marrëdhëniet familjare, në rastet kur janë të pajisura me UMM/UM gjatë kohës së vlefshmërisë së tyre si dhe në rastet kur nuk kanë përdorur mjetet ligjore;
- ✓ Referim të rastit në agjencitë e ndryshme në nivel vendor që ofrojnë mundësi arsimimi për fëmijët, mundësi punësimi për gratë të mbijetuara të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, etj, shërbime këto që mund të përfitohen edhe pas përfundimit të afatit të qëndrimit në strehëzën emergjente;
- ✓ Shoqërim i të mbijetuar/ës së dhunës në polici për të raportuar dhunën e pësuar, përgatitjen e kërkesës për vlerësimin e masave paraprake të mbrojtjes së menjëherëshme dhe përgatitjen e kërkesës për lëshimin e urdhrit të menjëherëshëm të mbrojtjes;
- ✓ Shoqërimi i të mbijetuar/ës së dhunës në familje në gjykatë për të marrë pjesë në seancat gjyqësore të çështjes me objekt lëshimin e urdhrit të menjëherëshëm të mbrojtjes për të mbijetuarit e dhunës në familje; Nëse rasti paraqet një rrezik të lartë, një punonjës/e policie gjithashtu, merr pjesë në shoqërimin e viktimës/ave për në gjykata e juridiksonit të përgjithshëm e shkallës së parë.
- ✓ Shoqërimi i të mbijetuarës në zyrën e përmbarimit dhe zyrën e shërbimeve sociale në bashkinë përkatëse me qëllim sigurimin e zbatimit të UMM.
- ✓ Shoqërimi i të mbijetuarës në zyrën e shërbimeve sociale në bashki për të marrë ndihmën ekonomike të parashikuar në lig/aktet nënligjore për të mbijetuarat e dhunës në familje të pajisura me urdhër të menjëherëshëm mbrojtje/urdhër mbrojtje;
- ✓ E mbijetuara e dhunës në familje do të informohet nga stafi i strehëzës mbi të gjitha shërbimet e vlefshme për të dhe fëmijët e saj në nivel bashkie, qarku, në nivel qëndror etj., bazuar në vlerësimin e nevojave.
- ✓ Shërbime për fëmijët që janë të mbijetuar/a të dhunës në familje ose kanë asistuar në skena dhune në familje; Këto shërbime ofrohen në bashkëpunim me strukturën e shërbimeve shoqërore, NJMF/PMF në bashki dhe ose njësinë administrative dhe organizatat e shoqërisë civile.
- ✓ Aktivitete plotësuese social kulturore për fëmijët.

Mbështetja psikologjike do të ofrohet nga:

- ✓ Një psikolog/e i bashkisë, në rastet kur psikolog/ia është pjesë e strukturës së bashkisë;

- ✓ Përmes një marrëveshje me institucionet në nivel bashkie ose qarku që kanë psikolog/e në dispozicion;
- ✓ Përmes një marrëveshje me organizatat e shoqërisë civile që ofrojnë shërbime psikologjike falas për të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje;
- ✓ Nga psikolog/e të Urdhrit të Psikologut, përmes një marrëveshjeje me Urdhërin e Psikologut, me qëllim ofrimin e shërbimit falas;
- ✓ Nga qendrat e shërbimeve publike;
- ✓ Në të gjitha rastet e sipërpërmendura, përfitues/et do të përfitojnë shërbim psikologjik falas, ndërkokë që psikolog/et që do ta ofrojnë këtë shërbim duhet të jenë patjetër të specializuara për trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, përfshirë dhunën ndaj fëmijëve.
- ✓ Përmes “Shërbimit psiko-social shkollor” në rastin e fëmijëve të dhunuar. Përmes këtij shërbimi psiko-social shkollor do tu ofrohet mbështetje fëmijëve/nxënësve për trajtimin e problematikave të ndryshme, sipas nevojave psiko-sociale. Ky shërbim do të ofrohet përmes bashkëpunimit me njësitë arsimore vendore.

Mbështetja ligjore, në formën e ndihmës juridike parësore do të ofrohet nga:

- ✓ Punonjësit me trajnim të posaçëm të punësuar në qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore, në ambientet e gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm e shkallës së parë ose në ambiente të tjera të përshtatshme; organizatat jo fitimprurëse për shërbimet e ndihmës juridike parësore, të autorizuara, bazuar në ligjin Nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.
- ✓ Klinikat ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë

Mbështetja ligjore në formën e ndihmës juridike dytësore do të ofrohet nga:

- ✓ Avokatët që përfshihen në listën e miratuar nga Doma Kombëtare e Avokatisë, të cilat/ët janë caktuar për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike dytësore nga organi proceduese ose doma vendore e avokatisë; në bazë të kërkesës së personit që gëzon të drejtën përfitimin e ndihmës juridike dytësore.
- ✓ Ky shërbim do t'u ofrohet përfitueseve falas;

Ofrimi i këtij shërbimi do të mundësohet përmes Marrëveshjes së Bashkëpunimit të lidhur midis bashkisë dhe Dhomës Vendore të Avokatëve, institucioneve përgjegjëse për adresimin e dhunës në marrëdhëniet familjare në nivel bashkie, anëtar/ëve të MR. Marrëveshjet do të synojnë ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike në mënyrë profesionale, cilësore, eficiente dhe efektive. Stafi i strehëzës emergjente informon viktimat/të mbijetuarat e dhunës në familje se ndihma juridike i ofrohet, pavarësisht të ardhurave dhe pasurisë së tyre për shkak se përfshihen tek kategoritë e veçanta të përfituesve të ndihmës juridike³⁵. Të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje informohen si në lidhje me të drejtat ligjore bazuar në legjislacionin administrativo civil kundër dhunës në familje ashtu edhe në legjislacionin procedural penal³⁶. Gjithashtu stafi lehtëson që avokatja/i të hyjë në marrëdhënie me personin, të cilin i është pranuar kërkesa për ndihmë juridike dytësore dhe të fillojë dhënien e shërbimeve të kërkua.

Shërbimi shëndetësor

Në rastet kur përfitues/et do të kenë nevojë për shërbim shëndetësor, Koordinatorja Vendore kundër dhunës në familje, në mbledhjen ad hoc të Ekipit Teknik Ndërdisiplinar prezanton

³⁵Ligji nr. 111/2017 për ndihmën juridike të garantuar nga shteti, nen 11, “Kategoritë e vecanta të përfitueseve të ndihmës juridike”.

³⁶Ligji nr. 35/2017 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i procedurës penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

rastin dhe kërkon nga spitali dhe/ose qendrat shëndetësore të ofrojnë shërbim shëndetësor falas për të mbijetuar/ën e dhunës me bazë gjinore apo dhunës në familje.

Mbështetja me veshje, ushqime, etj. do të mundësohet:

- ✓ Nga fondi i bashkisë;
- ✓ Nëpërmjet bashkëpunimit me organizatat joftimprurëse dhe aktorët e tjera në nivel vendor dhe qëndror. Koordinatorja Vendore kundër dhunës në familje referon rastin pranë këtyre organizatave ose aktorëve dhe institucioneve të tjera me qëllim sigurimin e ushqimeve dhe veshmbathjeve në rastet e akomodimit në strehëz të përfitues/eve.

Shoqërimi i të mbijetuar/ës së dhunës në polici, gjykatë, ose institucionet e tjera gjatë kohës së qëndrimit në strehëzën emergjente.

E/i mbijetuar/a e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje do të shoqërohet në polici, gjykatë ose institucionet e tjera nga Koordinatorja Vendore kundër dhunës në familje. Kur rasti është vlerësuar me një rrezik të lartë ose të mesëm, e mbijetuar/a e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje shoqërohet për në institucionet e lartpërmendura nga policia dhe koordinatorja vendore kundër dhunës në familje dhe/ose punonjësja e mbrojtjes së fëmijëve.

Gjatë kohës së qëndrimit të së mbijetuar/ës së dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje në strehëzën emergjente, përgjegjësit e programit të rehabilitimit raportojnë përpara koordinatorit vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, pjesëmarrjen e të paditurit në program dhe ecurinë e tij, në mënyrë periodike si dhe në përfundim të programit, në të cilin të përfshihen rezultatet e rehabilitimit të dhunuesit. Nëse dhunuesi/ja nuk merr pjesë në program, atëherë, me kërkesë të mbledhjes *ad-hoc* të mekanizmit të koordinuar të referimit të rasteve të dhunës në familje ose të subjekteve të parashikuara nga neni 13, i ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar, zbatohen dispozitat e Kodit Penal, për veprime të kryera në kundërshtim me vendimin e gjykatës për urdhrat e mbrojtjes. Koordinatori vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare njofton stafin e strehëzës emergjente, me qëllim sigurimin e jetës së të mbijetuar/ës së dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje³⁷. Në rastin e programeve të rehabilitimit në nivel vendor, ato ftohen të jenë pjesë e Mekanizmit të Referimit dhe informojnë koordinatoren vendore për pjesëmarrjen e të paditurit në program dhe ecurinë e tij, edhe në mbledhjet e ekipit teknik.

Nuk do të përbëjë kusht të pranimit të së mbijetuar/ës së dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje pajisja e saj me një urdhër të menjëhershëm mbrojtje nga gjykata e juridiksonit të përgjithshëm e shkallës së parë. Pajisja me UMM nuk nënkupton daljen e menjëhershme të viktims së dhunës nga strehëza emergjente, pa marrë të gjitha masat e nevojshme për sigurinë e jetës së saj jashtë ambjenteve të strehëzës apo pa qenë të sigurt që alternativa e paraqitur për vazhdimin e jetës së përfitues/es jashtë strehëzës emergjente, mundëson riintegrin e saj në jetën e përditshme (pra UMM zbatohet menjëherë dhe përfitues/ja ka të garantuar strehimin, ofrohen shërbime të tjera mbështetëse, etj). Përjashtim këtu përbëjnë rastet kur për shkak të rrezikshmërisë së lartë vlerësohet si një alternativë më e përshtatshme akomodimi në Qendrën Kombëtare të Përkujdesit Shoqëror për viktimat e dhunës në familje ose në strehëza rajonale që ofrojnë këto shërbime. Gjithsesi nuk duhet harruar që shërbimi i strehimit emergjent është afatshkurtër (maksimumi deri në shtatë ditë) ndaj dhe antarët e Mekanizmit të Referimit duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme dhe duhet të angazhoohen maksimalisht në gjetjen e një alternative afatgjatë dhe të qëndrueshme për zgjidhjen e situatës së paraqitur. Gjatë kohëzgjatjes së vendimit gjyqësor për UMM/UM-në,

³⁷ Ligji Nr. 47/2018, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, date 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", të ndryshuar, neni 11.

zyra e shërbimeve sociale të njësisë së vetëqeverisjes vendore monitoron respektimin e urdhrit të mbrojtjes nga palët dhe çdo 60 ditë përgatit një raport, për të cilin, në çdo rast, vë në dijeni Policinë e Shtetit. Stafi i strehëzës emergjente ruan një bashkëpunim të mirë me zyrën e shërbimeve sociale të njësisë së vetëqeverisjes vendore, Policinë e shtetit, koordinatoren vendore kundër dhunës në familje dhe anëtarët e tjerë të MR, përgjegjës për respektimin e UMM/UM, merr dhe jep informacion në lidhje me incidente dhune ose kërcënime për incidente dhune gjatë periudhës që e mbijetuara e dhunës akomodohet në strehëzën emergjente.

Trajnimi dhe kualifikimi

Stafi që punon në strehëzën emergjente duhet të marrë një minimum prej 30 orësh trajnim dhe ky trajnim duhet të mbulojë:

- Një analizë gjinore të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe dhunës ndaj grave;
- Teknika komunikimi dhe ndërhyrjeje
- Konfidencialiteti;
- Mbrojtja e fëmijëve;
- Akses në përkthim dhe shërbime për personat me aftësi ndryshe;
- Bashkëpunimi dhe si të bëjnë referimet e duhura në aktorët e tjerë;
- Informacion mbi traumën dhe mbijetesën;
- Vlerësimin e riskut;
- Mos diskriminimin dhe diversitetin;
- Fuqizimin;
- Njohuri bazike mbi standartet ndërkombëtare e kombëtare, legjislacionin kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje dhe standartet e shërbimit në strehëzat për viktimat/ të mbijetuar/at e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje;
- Të drejtat e përsituesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, përfshirë të drejtën efektive për ankim;

Siguria

Kur e mbijetuara e dhunës në familje nuk mund të akomodohet në strehëzën emergjente për shkak të moshës së djalit që e shoqëron atë, stafi i strehëzës sigurohet që i mundëson një tjetër opsjon akomodimi të sigurtë për familjen. Çdo alternativë akomodimi duhet të vlerësohet nëse është në përputhje me sigurinë e strehëzave emergjente dhe me politikat e konfidencialitetit.

Nevojat për arsim të fëmijëve.

Kur e mbijetuara e dhunës në familje është akomoduar në strehëz së bashku me fëmijën/ët e saj atëhere stafi i strehëzës emergjente asiston në edukimin e fëmijëve. Kjo do të sigurohet përmes një protokollit me shkollat në nivel lokal me qëllim përmbytjen e nevojave të fëmijëve. Gjithashtu, bashkitë duhet të sigurojnë që strehëzat emergjente kanë ambient të përshtatshëm me qëllim që fëmijët të kryejnë detyrat e shtëpisë gjatë kohës së qëndrimit në strehëz.

Aksesi në telefon:

Përsitues/et në strehëzën emergjente duhet të kenë akses në një telefon të qendrës ose një sistem që mundëson vetëm dhënien e një alarmi apo njoftimin urgjent të punonjës/eve të policisë dhe/ose koordinatoren vendore për një rrezik që u paraqitet. Kjo linjë telefonike nuk mundëson telefonata të tjera, me qëllim mos zbulimin e vendndodhjes së strehëzës dhe mos vënien në rrezik të jetës së viktimateve.

Një listë me numrat e telefonit të koordinatores vendore kundër dhunës në familje, punonjës/es së policisë dhe punonjës/es social/e pranë bashkisë publikohet në ambjentet e strehëzës emergjente.

STANDARDI 3:

Vlerësimi i nevojave dhe plani i përkujdesit për përfitues/en

Rezultati i dëshiruar:

Nevojat e përfitues/es, viktimi/e mbijetuar e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje të vlerësuara plotësish dhe në mënyrë të efektshme, sipas moshës, gjinisë dhe specifikimeve të tjera, si dhe plani individual i përkujdesit i hartuar në bazë të tyre.

STANDARDI 3.1.:

Ofruesi i shërbimit të strehimit emergjent vlerëson në mënyrë të menjëherëshme dhe me efektivitet nevojat e përfitues/es së shërbimit, duke marrë në konsideratë tërësinë e karakteristikave personale.

STANDARDI 3.2.:

Ofruesi i shërbimit të strehimit emergjent harton në bashkëpunim me përfitues/en e shërbimit planin individual të përkujdesit për të, bazuar mbi nevojat individuale gjinore të vlerësuara.

KRITERET	TREGUESI	UDHËZIMET
<ul style="list-style-type: none"> - Menjëherë pas pranimit të përfitues/es në shërbimin e strehimit, duhet bërë me të vlerësimi i nevojave dhe orientimi. - Vlerësimi i nevojave të përfitues/es duhet të bëhet brenda maksimumi 48 orëve (për nevojat emergjente), si dhe duhet të plotësohet më pas nga vlerësimi i nevojave afatgjata. Ky vlerësim bëhet në bashkëpunim me përfitues/en dhe me mbështetjen / ndihmën e grupit vendim-marrës për trajtimin e rastit në këtë qendër 	<p>3.1.1. Formulari i pranimit së bashku me informacionin orientues të nënshkruara nga përfitues/ja dhe të futura në dosjen e saj/tij.</p> <p>3.1.2. Formulari i vlerësimit të nevojave (emergjente dhe afatgjata), i plotësuar dhe futur në dosjen e përfitues/es.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Duke qenë se flitet për shërbim dhe rast emergjent, duhet të merret në konsideratë fakti që përfitues/ja mund të ketë dalë edhe pa dokumente identifikimi nga shtëpia. Pavarësisht kësaj, ofruesi i shërbimit të strehimit duhet të ketë një formular rregjistrimi/pranimi, i cili shoqërohet edhe me një informacion orientues, që duhet t'i vihen në dispozicion përfitues/es dhe duhet të nënshkruhen edhe prej saj.
<ul style="list-style-type: none"> - Stafi i ofruesit të shërbimit emergjent duhet të planifikojë planin e përkujdesit individual të përfitues/es, bazuar mbi vlerësimin e nevojave të saj/tij. 	<p>3.2.1. Plani individual i përkujdesit, i hartuar dhe miratuar edhe nga vetë përfitues/ja, bazuar në nevojat gjinore të saj/tij dhe i futur në dosjen e saj personale.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Lidhja e masave të planifikuara në planin e përkujdesit, me nevojat e përfitues/es (emergjente dhe afatgjata) është domosdoshmëri.

Shërbimet që do të ofrohen në strehëzat emergjente duhet të janë të specializuara, si dhe të disponueshme gjatë 24 orëve në të 7 ditët e javës. Po kështu, strehëzat emergjente duhet të

kenë infrastrukturë të përshtatur si dhe staf të specializuar për të pranuar dhe trajtuar të mbijetuara me aftësi të kufizuara, me probleme të shëndetit mendor, apo të varura nga substancat. Strehëzat emergjente do të sigurojnë që shërbimet për gratë dhe vajzat e dhunuara ofrohen nga specialiste gra dhe vajza. Strehëzat emergjente duhet të kenë një plan se si të trajtojë kufizimet në shtretër. Pavarësisht këtyre kufizimeve, në asnjë rast një grua viktimë e dhunës me bazë gjinore apo dhunës në familje, nuk mund të lihet pa iu ofruar shërbim në këtë strehëz emergjente ose në ndonjë tjetër strehëz tjetër të ngjashme, apo në një qendër rezidenciale që ofron shërbime të specializuara për gratë me aftësi të kufizuara, probleme të shëndetit mendor apo varësi nga substancat, në qark ose në nivel kombëtar. Asnjë e mbijetuar në rrezik të lartë për jetën, nuk mund të kthehet në shtëpi për të bashkëjetuar me dhunuesin në kushtet e mungesës së shtretërve në strehëzën emergjente, në kushte të mungesës së infrastrukturës (psh aksesueshmëria për gratë me aftësi të kufizuara), apo të personelit të specializuar për trajtimin e grave më aftësi të kufizuara, me probleme të shëndetit mendor apo varësi nga substancat. Koordinatorja Vendore kundër dhunës në familje, e emëruar si punonjëse me kohë të plotë pranë bashkisë, mund të marrë informacion në lidhje me rastin: (i) drejtëpërdrejt - nëse e mbijetuara nga dhuna me bazë gjinore apo dhuna në familje i drejtohet asaj ose (ii) nga aktorë të tjerë të Mekanizmit të Referimit - ku e mbijetuara e dhunës e ka raportuar dhunën e pësuar. Koordinator/ja Vendor/e do të jetë personi kryesor përgjegjës për marrjen e vendimit për pranimin (ose jo) të së mbijetuarës së dhunës në strehëzëz emergjente, *duke e marrë këtë vendim në bashkëpunim me të paktën një punonjës/e të policisë*. Kur është e mundur, ky vendim mund të merret edhe me praninë e specialisëve të tjerë si: një punonjës/e social/e apo jurist/e e specializuar në çështje të dhunës më bazë gjinore e dhunës në familje, si dhe një psikolog/e të specializuar (në rast të pranisë edhe të fëmijëve), të cilat mund të janë të punësuar/a pranë institucioneve anëtarë të Mekanizmave të Referimit. Ky grup bazë vendim-marrës (përbërja e të cilët varion në varësi të numrit të anëtarëve të mekanizmit të Referimit në secilën bashki, por që minimalisht përbëhet nga koordinator/ja vendor/e dhe nga një punonjës/e policie) duhet të jetë i përgatitur për t'u mbledhur dhe për të vendosur në çdo kohë që rasti të paraqitet në 24 orë, në 7 ditët e javës. Prandaj dhe institucionet përgjegjëse duhet të marrin masa që të mbështesin dhe lehtësojnë punën e atyre punonjës/eve që do të përfshihen në grupin vlerësues për pranimin e rasteve të paraqitura në strehëzëz emergjente.

Stafi i strehëzës emergjente dëgjon me kujdes dhe pa paragjykim të mbijetuar/ën e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Që në fillim të bisedës punonjës/ja e strehëzës emergjente e siguron përfitues/en që i gjithë informacioni do të trajtohet në mënyrë konfidenciale dhe do të mbetet anonim, me përjashtim të rasteve specifike kur ky konfidencialitet duhet të thyhet për të sigurinë e përfitues/es (rastet e thyerjes së konfidencialitetit duhet të janë pjesë e manualit të politikave dhe procedurave të ofruesit të shërbimit të strehimit emergjent). Një plan sigurie i veçantë (i përkujdesit individual) bazuar në historinë e dhunës së pësuar, incidenteve, formave të dhunës, etj., do të hartohet në bashkëpunim me aktorët e tjerë. E/i mbijetuar/a e dhunës me bazë gjinore apo dhunës në familje do të informohet në një formë të shkruar mbi të drejtat dhe detyrimet e saj/tij gjatë kohës së qëndrimit në strehëzëz emergjente si edhe pas daljes nga strehëza. Kjo formë do të firmoset nga përfitues/ja nëse bie dakord me rregullat e parashikuara. Në rastet kur ndaj dhunuesit/es ka filluar procedimi penal, organi i prokurorisë informon viktimin/të mbijetuar/ën e dhunës në lidhje me të drejtat bazuar në nenin 58 të Kodit të Procedurës Penale, Të drejtat e viktimës së veprës penale dhe nenit 58/1, "Të drejtat e viktimës së mitur".

E/i mbijetuar/a e dhunës me bazë gjinore apo dhunës në familje do të këshillohet nga stafi i strehëzës emergjente të mos ndajë informacionin me dhunesin/en e saj/tij gjatë kohës së

qëndrimit në strehëzën emergjente, sepse kjo mund të vërë atë dhe fëmijët e saj në rrezik. Viktima në strehëzën emergjente duhet të marrë informacion në lidhje me fazat e procedimit penal, në rast se dhunuesi lihet i lirë, etj. dhe ky informacion duhet të ndihmojë për një plan sigurie më efektiv dhe për përditësimin e vazhdueshëm të këtij plani.

Pjesë e planit individual do të jenë edhe identifikimi i miqve, anëtarëve të familjes, shërbimeve komunitare, etj, të cilat/ët mund të shërbejnë për zbatimin e planit të përkujdesit individual apo për trajtimin afatgjatë të viktimës/së mbijetuarës, edhe pas daljes nga strehëza emergjente. Roli i MR pas daljes së viktimës nga strehëza emergjente është shumë i rëndësishëm me qëllim përmbytjen e nevojave të saj dhe fëmijëve për mbështetje psikologjike, ligjore, ndihmë sociale, punë, banesë sociale, etj.

STANDARDI 4:

Të drejtat dhe përgjegjësitet e përfitues/eve

Rezultati i dëshiruar: Përfitues/et e shërbimit të strehimit emergjent gjëzojnë të gjitha të drejtat e parashikuara në ligj, trajtohen me dinjitet e respekt, si dhe mbrohen nga të gjitha format e abuzimit dhe diskriminimit gjatë kohës së qëndrimit në strehëzën emergjente.

STANDARDI 4.1.:

Ofruesi i shërbimit të strehimit emergjent ofron shërbimet për përfitues/et me tolerancë dhe mirëkuptim, respekt pa diskriminim për shakat të racës, ngjyrës, kombësisë, gjuhës, gjinisë, orientimit seksual, identitetit gjinor, bindjeve politike, fetare apo filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore apo shoqërore, shtatzanisë, të qenit prind, përgjegjësisë prindërore, moshës, gjendjes civile, vendbanimit, gjendjes shëndetësore, predispozitave gjenetike, aftësive të kufizuara, përkatësisë në një grup të caktuar apo për çfarëdo arsyesh të tjera.

KRITERET	TREGUESI	UDHËZIMET
<ul style="list-style-type: none"> - Informimi i përfitues/es me të drejtat dhe përgjegjësitet gjatë kohës së qëndrimit në strehëzën emergjente - Duhet të ketë një mekanizëm ankimi për përfitues/et dhe stafin, në rast të shkeljes së të drejtave të tyre. - Përfitues/ja të trajtohet si pjesëmarrës/e në program. 	<p>4.1.1. Broshurë/fletëpalosje/dokument i afishuar që përfshin të drejtat dhe detyrimet gjatë kohës së qëndrimit në strehëzën emergjente, përfshirë të drejtën e përfitimit të shërbimeve pa diskriminim.</p> <p>4.1.2. Procedurë ankimi me shkrim, që bën lidhjen me një sistem të jashtëm nëse ankesën nuk e zgjidh strehëza emergjente, e shpallur dhe e njojur nga të gjitha përfitues/et dhe stafi.</p> <p>4.1.3. Procedura të qarta ankimi i rast abuzimi nga stafi, kundrejt përfitueseve të shërbimit në strehëz, apo në rast abuzimi ndaj fëmijëve të cilët janë të pashoqëruar nga</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Është mirë të mbahet një bazë të dhënash më vete për të gjitha ankesat e depozituara dhe për zgjidhjen që u është dhënë. - Pjesëmarrja e përfitues/eve është thelbësore për të shkuar drejt vetëmjaftueshmërisë dhe fuqizimit.

qëndrimit në strehëzën emergjente, sepse kjo mund të vërë atë dhe fëmijët e saj në rrezik. Viktima në strehëzën emergjente duhet të marrë informacion në lidhje me fazat e procedimit penal, në rast se dhunuesi lihet i lirë, etj. dhe ky informacion duhet të ndihmojë për një plan sigurie më efektiv dhe për përditësimin e vazhdueshëm të këtij plani.

Pjesë e planit individual do të jenë edhe identifikimi i miqve, anëtarëve të familjes, shërbimeve komunitare, etj, të cilat/ët mund të shërbejnë për zbatimin e planit të përkujdesit individual apo për trajtimin afatgjatë të viktimës/së mbijetuarës, edhe pas daljes nga strehëza emergjente. Roli i MR pas daljes së viktimës nga strehëza emergjente është shumë i rëndësishëm me qëllim përmbytjen e nevojave të saj dhe fëmijëve për mbështetje psikologjike, ligjore, ndihmë sociale, punë, banesë sociale, etj.

STANDARDI 4:

Të drejtat dhe përgjegjësitë e përfitues/eve

Rezultati i dëshiruar: Përfitues/et e shërbimit të strehimit emergjent gjëzojnë të gjitha të drejtat e parashikuara në ligj, trajtohen me dinjitet e respekt, si dhe mbrohen nga të gjitha format e abuzimit dhe diskriminimit gjatë kohës së qëndrimit në strehëzën emergjente.

STANDARDI 4.1.:

Ofruesi i shërbimit të strehimit emergjent ofron shërbimet përfitues/et me tolerancë dhe mirëkuptim, respekt pa diskriminim për shakat të racës, ngjyrës, kombësisë, gjuhës, gjinisë, orientimit seksual, identitetit gjinor, bindjeve politike, fetare apo filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore apo shoqërore, shtatzanisë, të qenit prind, përgjegjësisë prindërore, moshës, gjendjes civile, vendbanimit, gjendjes shëndetësore, predispozitave gjenetike, aftësive të kufizuara, përkatësisë në një grup të caktuar apo përfitues/et arsyesh të tjera.

KRITERET	TREGUESI	UDHËZIMET
<ul style="list-style-type: none"> - Informimi i përfitues/es me të drejtat dhe përgjegjësitë gjatë kohës së qëndrimit në strehëzën emergjente - Duhet të ketë një mekanizëm ankimi përfitues/et dhe stafin, në rast të shkeljes së të drejtave të tyre. - Përfitues/ja të trajtohet si pjesëmarrës/e në program. 	<p>4.1.1. Broshurë/fletëpalosje/dokument i afishuar që përfshin të drejtat dhe detyrimet gjatë kohës së qëndrimit në strehëzën emergjente, përfshirë të drejtën e përfitimit të shërbimeve pa diskriminim.</p> <p>4.1.2. Procedurë ankimi me shkrim, që bën lidhjen me një sistem të jashtëm nëse ankesën nuk e zgjidh strehëza emergjente, e shpallur dhe e njojur nga të gjitha përfitues/et dhe stafi.</p> <p>4.1.3. Procedura të qarta ankimi i rast abuzimi nga stafi, kundrejt përfitueseve të shërbimit në strehëz, apo në rast abuzimi ndaj fëmijëve të cilët janë të pashoqëruar nga</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Është mirë të mbahet një bazë të dhënash më vete përfitues/et gjitha ankesat e depozituara dhe përfitues/et që u është dhënë. - Pjesëmarrja e përfitues/et është thelbësore përfitues/et shkuar drejt vetëmjaftueshmërisë dhe fuqizimit.

Koha e qëndrimit të një të mbijetuarë të dhunës me bazë gjinore apo dhunës në familje në strehëzën emergjente është e kufizuar. Kjo kohë qëndrimi **do të zgjasë maksimumi 7 (shtatë)** ditë me qëllim menaxhimin e situatës emergjente të së mbijetuarës së dhunës me bazë gjinore apo dhunës në familje. Dalja e të mbijetuarës nga strehëza emergjente do t'u njoftohet antarëve të Mekanizmit të Referimit dhe trajtimit të rasteve të dhunës në familje në nivel vendor, me qëllim që rasti të monitorohet nëse do të kthehet në ambient familjar (në zbatim të UMM/UM të lëshuar nga Gjykata), ose me qëllim që të sigurohet që e mbijetuara e dhunës ka kaluar nga strehëza emergjente në një strehëz me qëndrim më afatgjatë. Nëse rasti kthehet në ambient familjar menaxhim i rastit nga bashkitë dhe anëtarët e Mekanizmave të Referimit përfshin edhe fuqizimin e grave përmes përgatitjes së një plani për punësimin, strehimin, mbështetjen psiko sociale, ndihmat ushqimore emergjente, etj., në varësi të nevojave të rastit dhe në bashkëpunim me aktorë të tjera. Njësitë e vetëqeverisjes vendore të mbështetura edhe nga Ministria përgjegjëse për çështjet e strehimit marrin masa për sigurimin e banesave të specializuara për viktimat e dhunës në familje, sipas legjislacionit në fuqi për strehimin social.”.

Shërbimet për të mbijetuarat e dhunës në familje sigurohen pa diskriminim mbi bazë gjinie, race, ngjyre, gjuhe, feje, mendimi politik ose mendimi tjetër, origjine kombëtare ose sociale, përkatësie në një pakicë kombëtare, pasurie, lindjeje, orientimi seksual, identiteti gjinor, moshe, gjendjeje shëndetësore, aftësie të kufizuar, statusi civil, statusi emigranti ose refugjati ose statusi tjetër. Njësitë e vetëqeverisjes vendore (bashkitë) sigurojnë që stafi që shërben në strehëzat emergjente ka njohuri të mjaftueshme të ligjt Nr.10 221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe përfitueset kanë njohuri mbi të drejtat që u burojnë nga legjislacioni kundër diskriminimit.

Shërbimet në këto strehëza emergjente do të ofrohen falas. Strehëzat duhet të jenë të aksesueshme nga gratë dhe fëmijët viktima të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje që u përkasin grupeve të ndryshme të marginalizuara si grave nga komunitetet rome, egjiptiane, grave dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara, grave nga zonat rurale, grave migrante, grave azil kërkuese, grave të komunitetit LBTI, etj. Në të gjitha rastet, duhet të merret në konsideratë edhe fakti që gratë mund të kenë dalë nga shtëpia e tyre pa asnjë lloj dokumenti identifikimi (në varësi të situatës dhe dhunës së ushtruar). Nëse një grua e mbijetuar e dhunës me bazë gjinore, përfshirë dhunën në familje është referuar nga anëtarë të Mekanizmit të Referimit dhe nuk është pajisur me dokumentacionin ligjor prej tyre, i takon Sektorit të Shërbimeve Sociale në bashki dhe koordinatores vendore kundër dhunës në familje të koordinojë veprimet me anëtarët e tjere me qëllim pajisjen e të mbijetuarës së dhunës me dokumentacionin përkatës ose vënien në dispozicion të këtij dokumentacioni stafit të strehëzës emergjente. Me qëllim aksesin e grave dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara, strehëzat emergjente duhet të përbushin parimin bazë të përshtatshmërisë së arsyeshme si dhe interpretues/en e gjuhës së shenjave për personat që kanë nevojë për këtë lloj shërbimi. Masa duhet të merren për të pasur në dispozicion edhe një përkthyes/e për rastet e grave të huaja, me qëllim mundësimin e shërbimit në gjuhën e tyre. Me qëllim aksesin e grave të zonave rurale apo grupeve të tjera që jetojnë në një distancë nga strehëza emergjente, anëtarët e Mekanizmit të Referimit duhet të sigurojnë transportin falas të tyre deri në ambientet e strehëzës (me burime nga bashkia, anëtarë të tjera të MR, ose burime të tjera si projekte, organizata ndërkombëtare, biznesi, OJF, etj) dhe duhet të bashkëpunojnë me SPZ, kryepleqtë ose stafin e njësive administrative përkatëse. Kur nga vlerësimi i rastit rezulton se të mbijetuarat e dhunës, përfshirë dhunën në familje kanë probleme të rënda të shëndetit mendor, janë në varësi të alkolit, drogës, etj, koordinatorja vendore kundër dhunës në familje referon rastin në shërbimet e specializuara në nivel vendor nëse janë të vlefshme ose në ato në nivel kombëtar. Shërbimet në këto raste duhet të jenë të specializuara dhe të mbështetura

si duhet. Nga ana tjetër, informohet policia dhe anëtarët e tjera të ekipit teknik ndërdisiplinor, me qëllim që marra e masave për ndjekjen e programeve të sipërpërmendura të përfshihet në kërkesë padinë për lëshimin e UMM/UM.

Strehëzat emergjente do të ofrojnë shërbime për viktimat dhe do të garantojnë sigurinë për to, pavarësisht vendbanimit ose vendqëndrimit të viktimës. Kjo mbrojtje nënkupton asistencën për strehim të përkohshëm, transportin drejt një strehimi të sigurt ose drejt shërbimeve të kërkuara, shoqërimin drejt urgjencës ose shërbimeve mjekësore të domosdoshme ose pranë shërbimeve të mbrojtjes së viktimate të dhunës në familje.

STANDARDI 5:

Të dhënat personale të përfitues/es dhe administrimi i tyre.

Rezultati i dëshiruar:

Të drejtat e përfitueseve të shërbimit mbrohen nga legjislacioni në fuqi që rregullon të dhënat e kësaj natyre, si dhe rregullat e përcaktuara në rregulloren e ofruesit të shërbimit të strehimit emergjent, për ruajtjen dhe mbrojtjen e të dhënave.

STANDARDI 5.1.:

Mbledhja dhe ruajtja e të dhënave personale të përfitueseve të shërbimeve në strehëzën emergjente të kryhet duke siguar përdorimin e tyre në mënyrë profesionale. Ofruesi i shërbimit të strehimit emergjent ruan dhe përpunon të dhënat për rastet e dhunës në familje në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe mbështetet në parimin e ruajtjes së fshehtësisë së të dhënave.

KRITERET	TREGUESI	UDHËZIMET
<ul style="list-style-type: none"> - Dosja të jetë kofidenciale dhe të mund të shihet vetëm nga përfitues/ja dhe punonjës/ja sociale ose administrator/ja e strehëzës emergjente. - Për identifikimin e përfitues/es në dosje të përdoren vetëm numra të zgjedhur në mënyrë të rastësishme. Për fëmijët, të mos përdoren inicialet, por fëmija 1, 2, etj.. i prindit. - Në dosjen e përfitues/es të përfshihen të gjitha dokumentat e mundshme që të përdoren në momentin e duhur në procesin gjyqësor. - Ofruesi i shërbimit të strehimit emergjent të ketë një rregullore të qartë ku të përshkruhen saktësisht e me gjuhë të kuptueshme të gjitha të drejtat 	<p>5.1.1. Të dhënat personale mbahen në dosje të myllura ose, nëse ruhen në kompjuter, mund të hapen vetëm me fjalëkalim nga personi përgjegjës.</p> <p>5.1.2. Dokumentacioni mbështetës (prova, vizitë nga mjeku, etj) i përfshirë në dosjen e përfitues/es dhe i gatshëm për t'u përdorur në procesin gjyqësor</p> <p>5.1.3. Rregullorja me të drejtat dhe përgjegjësitë e përfitues/es, e afishuar dhe e përgatitur me një gjuhë të qartë e të kuptueshme.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Meqenëse këto janë raste emergjente, çdo provë e mbledhur ka rëndësi të veçantë dhe duhet të ruhet në mënyrën e duhur. - Ofruesi i shërbimit të strehimit emergjent duhet të jetë në gjendje të vlerësojë se deri në cilën masë respektohet konfidencialiteti i të dhënave dhe duhet të njoftojë edhe përfitues/en kur ky konfidencialitet duhet të thyhet. <p>Përfitueset informohen në lidhje me të drejtën e tyre për ankım pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale kur cënohet</p>

dhe detyrimet e përfitues/es dhe detyrimi i stafit për të informuar përfitueset në lidhje me këto të drejta.		konfidencialiteti i të dhënave.
--	--	---------------------------------

Të dhënrat e të mbijetuarave të dhunës me bazë gjinore apo dhunës në familje që do të përfitojnë nga shërbimet në strehëzën emergjente do të ruhen në mënyrë konfidenciale dhe përfitues/et e shërbimeve do të informohen nga stafi në lidhje me situatat në të cilat konfidencialiteti mund të kufizohet. Stafi i punësuar apo kontraktuar on-call në strehëzat emergjente nënshkruan një deklaratë mbi respektimin e konfidencialitetit të të dhënave të grave dhe fëmijëve viktima/të mbijetuara të dhunës, si dhe detyrime që lidhen me përpunimin e të dhënave dhe detyrime të tjera, të cilat burojnë nga Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Përmbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

STANDARDI 6:

Administrimi i brendshëm i strehëzës emergjente

Rezultati i dëshiruar:

Përmes administrimit të brendshëm, ofruesi i shërbimit të strehimit emergjent siguron shërbim dhe funksionim eficent për të arritur qëllimin, vlerat dhe parimet e praktikës më të mirë në terren.

STANDARDI 6.1.:

Ofruesi i shërbimit të strehimit emergjent të ketë mekanizmat e duhura formale të administrimit të brendshëm për funksionimin e strehëzës emergjente dhe shërbimet që ofron.

KRITERET	TREGUESI	UDHËZIMET
<ul style="list-style-type: none"> - Ofruesi i shërbimit të strehimit të ketë strukturën e nevojshme dhe stafin e kualifikuar/me përvojë për të realizuar shërbimet - Staf i punësuar të jetë i përshtatshëm për nevojat e përfitues/eve dhe të rekrutohet me procedurë të hapur e sipas legjislacionit në fuqi. - Ofrimi i trajnimeve përfuqizimin e kapacitetit të stafit si dhe kryerja e vlerësimit të performancës së punës, ndihmojnë në përmirësimin e eficencës dhe efektivitetit të ofruesit të shërbimit të strehimit emergjent 	<ul style="list-style-type: none"> 6.1.1. Organigrama e ofruesit të shërbimit të strehimit emergjent dhe lista e stafit (on call) 6.1.2. Procedura e rekrutimit të stafit e dokumentuar sipas të gjitha hapave të ndjekura. 6.1.3. Lista e trajnimeve të kryera për parandalimin dhe trajtimin e çështjeve të dhunës në familje si dhe materialet përkatëse të ruajtura. 6.1.4. Data bazë e stafit e plotësuar me trajnimet dhe kualifikimet e marra. 6.1.5. Procesi i vlerësimit me shkrim i dokumentuar dhe i 	<ul style="list-style-type: none"> - Përgjedhja e stafit të bëhet në përputhje me natyrën e shërbimit dhe parimet kryesore të ofrimit të tij. Përsa i takon numrit të anëtarëve të stafit që duhet të ketë një strehëz emergjente, kjo varion në bazë të kapacitetit të strehëzës dhe raporti i numrit të anëtarëve të stafit përkundrejt numrit të përfitues/eve duhet të përcaktohet dhe në bazë të shërbimeve që ofron strehëza emergjente në tërsi. - Gjatë përgjedhjes të mbahet në konsideratë edhe e drejta e

	<p>kryer sipas parimeve të vlerësimit të performancës në punë.</p>	<p>përfitues/es për të kërkuar ofrim të shërbimit nga staf i të njëjtës gjini.</p> <p>- Vlerësimi i nevojave të stafit për kualifikim dhe ofrimi i kualifikimit të munguar duhet të bëhen përpala procedurës së vlerësimit të performancës në punë.</p>
--	--	---

Përgjegjësia për menaxhimin e strehëzave emergjente të ngritura pranë njësive të vetëqeverisjes vendore, është e këtyre të fundit, pra e bashkive. Bashkia duhet të sigurojë që shërbimet janë menaxhuar efektivisht dhe strehëza emergjente është e mbështetur financiarisht mjafsheshëm për të ofruar sigurinë e të mbijetuarave të dhunës dhe ofrimin e shërbimeve bazë, si ushqim, veshje, shërbim psikologjik, ligjor, mjekosor, transport falas, etj. Fondi social i bashkisë, mbështetja nga donatorë të ndryshëm, OJF, biznese lokale, etj janë disa nga burimet e financimit. Në bashkitë ku ekzistojnë strehëza emergjente që menaxhohen nga organizata të shoqërisë civile, pushteti vendor mund të kontraktojë OJF-të lokale për ofrimin e këtij shërbimi. Ndërkoq që anëtarët e Mekanizmit të Referimit janë gjithashtu përgjegjës për sigurimin e shërbimeve të tillë si shërbimi psikologjik, mjekësor, ligjor, etj., këto përgjegjësi saktësohen në një marrëveshje specifike të nënshkruar nga anëtarët për mirëfunksionimin e strehëzës emergjente. Shërbimi Social Shtetëror harton dokumentacionin tip përfitues/et e shërbimeve shoqërore në strehëzat emergjente për gratë, viktima të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje. Bashkia duhet të marrë masa dhe të sigurojë një minimum të stafit që duhet të jetë në disposicion në momentin e akomodimit të një të mbijetuar/e të dhunës me bazë gjinore apo dhunës në familje në strehëz. Minimalisht duhet të llogaritet *qëndrimi/shoqërimi i të mbijetuarës nga një punonjës/e e specializuar për këtë qëllim, përgjatë gjithë kohës së qëndrimit të të mbijetuarës në strehëzën emergjente, si dhe me tre turne (pra përgjatë gjithë harkut kohor 24 orësh).* Pra, viktima/e mbijetuara nuk mund të lihet vetëm në strehëzën e emergjencës dhe pa shoqërimin/mbikqyrjen e një punonjës/eje të specializuar. Bashkia mund ta sigurojë këtë shërbim si përmes burimeve të veta dhe kontraktimit të punonjës/eve të specializuara për këtë qëllim, ashtu edhe përmes bashkëpunimit me OJF e specializuara që ofrojnë shërbime kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje (duke e blerë/prokuruar këtë shërbim). Po kështu, duhet të merren masa që të sigurohet edhe staf për kujdesin mjekësor, juridik, etj., sipas nevojës së të mbijetuarës. Në rast të pranisë së fëmijëve duhet të merren masa për të pasur të pranishëm edhe një specialist/e për trajtimin dhe mbështetjen psiko sociale të fëmijëve të dhunuar. Këto shërbirje mund dhe duhet të sigurohen në bashkëpunim dhe me institucione e organizata të tjera përgjegjëse dhe mund të jenë shërbime me kontratë e kohë të pjeshme. Kështu, shërbimi psikologjik falas për të miturit e dhunuar mund të sigurohet nëpërmjet: bashkëpunimit me Urdhrin e Psikologut³⁸, psikologëve, anëtarë të stafit të specializuar në bashki, bashkëpunimit me psikologen e shkollave ose psikologe të organizatave të shoqërisë civile që ofrojnë këto shërbime të specializuara dhe falas. Edhe bashkëpunimi me Urdhrin e Punonjësve Socialë³⁹ është i një rëndësie të veçantë. Gjithashtu duhet të respektohet dhe e drejta e të pyeturit të viktimës/së mbijetuarës nëse dëshiron që shërbimi t'i ofrohet patjetër nga një punonjëse grua. Anëtar/et e stafit të strehëzës emergjente do të jenë përgjegjës/e për

³⁸ Ligji Nr. 40/2016, "Për urdhrin e psikologut në Republikën e Shqipërisë", nen 12.

³⁹ Ligji nr. 163/2014 "Për urdhrin e punonjësve sociale në Republikën e Shqipërisë"

sigurinë e të mbijetuarës së dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje dhe fëmijëve të saj, si edhe ofrimin e shërbimeve me cilësinë e duhur nga një staf mbështetës dhe i mirë trajnuar. Stafi i strehëzës emergjente ka një kulturë besimi dhe respekti ndaj të mbijetuarave të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje të akomoduara në strehëzën emergjente. Stafi trajnohet nga Shërbimi Social Shtetëror. Drejtoria /Përgjegjësja e Zyrës së Shërbimeve Sociale në bashki dhe Shërbimi Social monitorojnë dhe vlerësojnë shërbimet bazuar në standartet e miratuarës dhe në vlerësim përfshijnë edhe mendimin e përsfitueseve. Inspektorati i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror ka detyrën të kontrollojë zbatimin e kritereve dhe të kushteve, të inspektojë standartet e shërbimeve të ofruara dhe të përmbushë funksionet dhe kompetencat e përcaktuara në nenin 35 të ligjit Ligji nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë".

Ambjenti i strehëzës emergjente duhet të jetë një ambjent i përshtatshëm dhe miqësor për të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje dhe të fëmijëve të tyre, me qëllim që të ndihmojë përrikuperimin e eksperiencave traumatike. Fëmijët, (djem dhe vajza) që nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç të shoqëruar/a, apo me lejen me shkrim nga një nga prindërit e tyre ose kujdestar/ja ligjor/e, apo me UPMM, do të mund të përfitojnë shërbime të sigurta gjatë kohës së qëndrimit në strehëzën emergjente. Në rastet kur fëmijët janë përsfitues të shërbimeve të ofruara në strehëzat emergjente, stafi i strehëzave ka detyrimin të garantojë të gjitha të drejtat e fëmijëve dhe të përmbushë përgjegjësitë që burojnë nga ligji. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".

Fëmijët 0-18 vjeç të dhunuar në familje, të shoqëruar nga nëna ose të pashoqëruar nga prindërit, të identifikuar nga strukturat përgjegjëse si viktima të dhunës në familje përfitojnë shërbime në strehëzat emergjente. Në rast të prindërve abuzues, atëhere akomodimi i fëmijës në strehëzen emergjente bëhet me miratimin me shkrim të Drejtorisë së Shërbimeve Shoqërore në bashki. Drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore është përgjegjës përmarrjen e vendimit për masat e mbrojtjes së fëmijës, bazuar në propozimin e punonjësit përmbrrojtjen e fëmijës dhe të grüpuit teknik ndërsektorial, sic parashikohet në ligjin nr.18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës". Pranimi i viktimateve të mitur në strehëzën emergjente shoqërohet me kryerjen e një raporti vlerësimi psiko social për të mbijetuarët/in e mitur.

Akomodimi i fëmijës në strehëzën emergjente në këto raste mund të bëhet edhe me UPMM e lëshuar kryesisht nga Organet përgjegjëse përrajtimin e rasteve të dhunës në familje pranë Policisë së Shtetit. Organet përgjegjëse përrajtimin e rasteve të dhunës në familje pranë Policisë së Shtetit kur vlerësojnë se, dhuna ushtrohet ndaj fëmijëve, marrin masa të menjëhershme përralimin e dhunës dhe kryesisht, nxjerrin Urdhrin Paraprak të Mbrotjes së Menjëhershme, UPMM, i cili mund të përfshijë edhe masën e vendosjes së të miturit në strehëzën emergjente.

Nëse strehëza emergjente ka shtretër apo hapësira të kufizuara, të tillë që nuk mund të akomodohen njëkohësisht disa viktima (pra ka më shumë trajtë e një dhome emergjence), dhe nuk janë miqësore përviktima/të mbijetuar të mitur, atëherë punonjës/et e strehëzës emergjente duhet të marrin masa që rastin ta strehojnë në një strehëzë tjeter lokale apo kombëtare. Stafi i strehëzës emergjente duhet të ofrojë ose referojë fëmijët në shërbime të specializuara përfëmijë të mbijetuar të dhunës në familje ose që kanë asistuar në skena dhune mes anëtarëve të familjes së tyre.

Bashkia si ofruese e këtij shërbimi përviktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje miraton një procedurë përruajtjen e fshehtësisë së vendit të strehëzës emergjente me qëllim sigurimin e jetës së viktimateve dhe stafit të strehëzës. Po kështu, ajo merr të gjitha masat përralimin e burimeve të duhura financiare e njerëzore përvazhdimësinë e

shërbimit të strehimit emergjent, si dhe kompletimin e tij me më shume burime në dispozicion, qoftë përmes sigurimit të bashkëpunimit të qendrueshëm me aktorët e tjerë në nivel vendor dhe qëndror, qoftë edhe nëpërmjet përfshirjes së këtij grupi shpenzimesh si pjesë e planeve buxhetore të bashkisë. Në rastin e strehëzave emergjente, çdo strehëz emergjente duhet të ketë një dhomë të veçantë të vlefshme për nënrat me fëmijë, të cilat janë viktima të abuzimit dhe dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje. Pajisjet kryesore që duhet të përmbajë një strehëz emergjente përfshijnë por nuk kufizohen në: shtretër për të rritur dhe fëmijë, çarçafë, jorganë dhe jastëkë, pajisje guzhine (për gatim dhe ngrënje), pajisje lavanderie (lavatrice, detergjentë, tharëse, hekur, etj), tavolinë dhe karrige për t'u ulur për të ngrënë apo për të bërë fëmijët detyrat, televizor, frigorifer, dollap, abazhur, lodra për fëmijë, libra dhe informacion për të rritur, etj. Po kështu është mirë që strehëza të jetë e pajisur me sete të ndihmës emergjente që sigurojnë minimumin e veshjes dhe kujdesit vetjak, si dhe me ushqime që mund të përdoren dhe gatuhen në çdo kohë. Rregullat në lidhje me mirëmbajtjen e pajisjeve dhe përdorimin e tyre, veprimet në rast zjarri, etj, publikohen në ambientet e strehëzës emergjente. Po këtu publikohet edhe numri i telefonit të shërbimit të policisë dhe atij zjarrfikës.

STANDARDI 7: Monitorimi dhe vlerësimi

Rezultati i dëshiruar:

Të garantohen shërbime të cilësisë së lartë përmes monitorimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm të punës.

STANDARDI 7.1.:

Ofruesi i shërbimit të strehimit emergjent ofron shërbime cilësore për viktimat/të mbijetuar/at e dhunës në familje, edhe përmes procesit të monitorimit, vlerësimit dhe mësimit.

KRITERET	TREGUESI	UDHËZIMET
- Ofruesi i shërbimit të strehimit emergjent të ketë strukturën e vet të cilës t'i jetë ngarkuar detyra e monitorimit dhe vlerësimit të brendshëm, duke mbajtur në konsideratë standarde cilësisë së shërbimeve që duhen përbushur.	<p>7.1.1. Personat përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin janë të identifikuar në organigramë dhe përshkrimet e punës.</p> <p>7.1.2. Procedura e monitorimit dhe vlerësimit të kryer, e dokumentuar hap pas hapi.</p>	<p>- Është mirë të tregohet gjithmonë kujdes për zhvillimet në fushën e udhëzimeve për praktikat më të mira dhe synimet e sigurisë, vetëmjaftueshmërisë dhe fuqizimit.</p>

STANDARDI 8: Qasja e koordinuar shumë-sektoriale dhe bashkëpunimi midis aktorëve në nivel vendor

Rezultati i dëshiruar:

Të garantohet ofrimi i shërbimeve dhe trajtimi i rasteve në mënyrë të koordinuar dhe përmes aplikimit të qasjes shumë sektoriale dhe bashkëpunimit të aktorëve në nivel vendor.

STANDARDI 8.1:

Shërbimet që ofrohen në strehëzën emergjente marrin në konsideratë dhe aplikojnë qasjen e koordinuar shumë sektoriale dhe parimin e bashkëpunimit, duke ndjekur modelin e Mekanizmit të referimit dhe trajtimit të rasteve të ngritur në nivel vendor.

KRITERET	TREGUESI	UDHËZIMET
- Ofroresi i shërbimit të strehimit emergjent të aplikojë tërësinë e shërbimeve të parashikuara, bazuar në qasjen shumë sektoriale të koordinuar (në përputhje me filozofinë e Mekanizmit të Referimit, të ngritur në nivel vendor).	8.1.1. Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet aktorëve në nivel vendor për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, e nënshkruar dhe me strehezën emergjente të përfshirë si anëtarë të këtij mekanizmi	- Identifikimi i institucioneve dhe aktorëve përgjegjës në nivel vendor të cilët do të nënshkruajnë marrëveshjen e bashkëpunimit për Mekanizmin e Referimit dhe do të trajtojnë rastet sipas qasjes shumë-sektoriale, të bëhet bazuar në përbajtjen e ligjit dhe VKM-së respektive.

- E gjithë veprimtaria e strehëzës emergjente do të përshkohet nga përgjegjësia ligjore e koordinimit të veprimeve dhe zbatimit të qasjes së koordinuar shumë-sektoriale me anëtarë të tjerë të Mekanizmit të Referimit dhe trajtimit të rasteve të dhunës në familje, në nivel bashkie. Po kështu, në këtë shërbim do të mbahen në konsideratë të gjitha parimet e ofrimit të shërbimeve sipas qasjes së koordinuar shumë-sektoriale, të cilat fillojnë që nga vendosja e viktims/së mbijetuarës në qendër të shërbimeve, ofrimi i sigurisë dhe privatësisë, shërbime të koordinuara e cilësore të ofruara në kohë e me efektivitet, vendosja e dhunuesit përpara përgjegjësisë, trajtimi me kujdes dhe sipas nevojës në terma urgjente, afatmesme e afatgjata, mundësia e marrjes së vendimeve në bazë të informacionit të përditësuar mbi të drejtat e detyrimet e viktimave/ të mbijetuarave dhe shërbimet në dispozicion të tyre, trajtimi në një mjedis që siguron respekt, dinjitet e ndjeshmëri, si dhe sfidimi i tolerancës ndaj dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje. Shoqërimi i viktims tek strehëza emergjente do të bëhet nga një punonjës/e e policisë dhe/ose Koordinator/ja Vendor/e, kur rasti është identifikuar nga anëtarët e Mekanizmit të Referimit. Punonjësja sociale pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore mund të referojë rastin për akomodim në strehëzën emergjente. Viktimat e dhunës me bazë gjinore, përfshirë viktimat e dhunës në familje, mund të paraqiten edhe vetë në ambjentet e bashkisë pasi kanë marrë informacion për funksionimin dhe shërbimet e strehëzës emergjente. Në këtë rast, përgatitet nga stafi i strehëzës emergjente një raport vlerësimi i situatës dhe nevojave të viktims/të mbijetuarës nga dhuna me bazë gjinore. Në rastet kur një grua e dhunuar me fëmijët e saj vetë referohen dhe kërkojnë akomodim, pasi ka marrë informacion nga media, stafi i strehëzës komunikon me SPZ e lagjes apo fshatit, me kordinatoren vendore kundër dhunës në familje për të marrë më shumë informacion rrëth rastit si edhe me policinë për vlerësimin e riskut dhe marrjen e një Urdhri për masa paraprake të menjëherëshme të mbrojtjes.

E RËNDËSISHME:

PËR NJË FUNKSIONIM SA MË TË MIRË DHE EFICENT TË STREHËZËS EMERGJENTE, DUHET TË MERREN NË KONSIDERATË DHE TË PËRSHTATEN APO APLIKOHEN FORMULARËT E OFRIMIT TË SHËRBIMIT, KRITERET E PRANIMIT, FORMULARËT E VLERËSIMT, ETJ., SIÇ APLIKOHEN NË RASTIN E SHËRBIMIT TË STREHIMIT AFATGJATË.

Standardët e miratuara do të shoqërohen me një udhëzues për bashkitë, lidhur me administrimin e strehëzave. Në rast të evidentimit të problemeve në zbatimin e standardeve në praktikë, do të kryhet rishikimi i tyre.